

KDI-ja: Legjislatura e re ta ketë prioritet miratimin e rregullores së re të punës | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI | FAQE 4-5



AKR-ja NUK PËLQEN TË BËHET PJESË E KOALICIONIT TË ARDHSHËM QEVERISËS

Kryetari i Kuvendit të Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka treguar se ky subjekt politik pritet të jetë në opozitë gjatë legjislaturës së shtatë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka

e re", ai ka thënë se kjo parti nuk pëlqen të bëhet pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës. Sipas tij, të qenit në opozitë gjatë mandatit të ardhshëm do t'i mundësojë kësaj partie që t'i bëjë reformat e

nevojshme brendapartiake. Matoshi është shprehur i bindur se në këtë mënyrë do të rritet përkrahja e qytetarëve të Kosovës ndaj AKR-së ashtu siç janë duke u fuqizuar partitë liberale në Evropë

OPINION

EKIPI MJEKO-LIGJOR ZVICERAN NUK PAJTOHET ME EKIPIN MJEKO-LIGJOR TË KOSOVËS RRETH DIAGNOZËS SË VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT F. 10

Shkruan:
Bardhyl
MAHMUTI



AKTUALE



THAÇI: EMANCIPIMI I GRUAS NË KOSOVË ËSHTË EMANCIPIMI I TËRË SHOOËRISË F. 7

VENDOSËN SHENJAT ORIENTUESE NË HAPËSIRAT E QKUK-së F. 7

EKONOMI

ATK-ja VAZHDON TA KONFISKOJË PASURINË E TATIMPAGUESVE BORXHLINJ F. 9

ODA AMERIKANE, AKTIVITETE INSPIRUESE PËR TË RINJTË F. 9

KULTURË

'LIBRI I LUFTËS' I NUHI BYTYÇIT ÇMOHET VEPËR ME VLERA HISTORIKE EDHE NË TETOVË F. 17

Me protestë kundërshtohet vendimi i BQK-së për shtrenjtimin e sigurimeve | FAQE 9



Marrëveshja LV - LDK, 72 orë pas certifikimit të rezultateve

 | FAQE 3

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, janë pajtuar të premtën që ta kenë marrëveshjen për koalicion qeverisës menjëherë pas certifikimit të rezultateve. Kurti dhe Mustafa pas takimit kanë bërë me dije se marrëveshjen për bashkëqeverisje do ta kenë 72 orë pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ata kanë mohuar se në këtë



takim kanë biseduar për ndarje të posteve ministore apo për postin e presidentit

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

DASH-i po ndjek situatën pas komenteve të presidentit Meta

TIRANË, 22 NËNTOR - Departamenti i Shtetit thotë se "është në dijeni" të komenteve të presidentit Ilir Meta ndaj Ambasadës së Shteteve të Bashkuara dhe diplomatëve amerikanë dhe se "është duke e vëzhguar situatën". Pas sugjerimit të së enjtes të Ambasadës amerikane në Tiranë

që Shqipëria t'i drejtohej për opinion Komisionit të Venecias lidhur me përplasjen për çështjen e emërimeve të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, presidenti Meta u shpreh me një gjuhë të ashpër duke thënë "Jo më shtet të ambasadave, por shtet të së drejtës".

Duke iu përgjigjur interesimit të "Zërit të Amerikës" për komentet e së enjtes të presidentit Meta, zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit tha se "respektimi i ligjit është mbi të gjitha". "Qëndrimi i Shteteve të Bashkuara nuk ka ndryshuar", thotë zëdhënësi, duke shtuar se

"vazhdimi i përparimit me reformat është jetik për stabilitetin dhe begatinë e Shqipërisë, si dhe për çuarjen përpara të synimit tonë të përbashkët, atë të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian". Shtetet e Bashkuara, shton më tej zëdhënësi, "do të



vazhdojnë të mbështetin Shqipërinë si një vend mik, partner dhe aleat, teksa vendi kryen reforma jetike".

Komisioni i Senatit miraton emërimin e Yuri Kimit për ambasadore në Shqipëri



jonte Shqipërinë për të arritur nivelin 2 për qind në shpenzimet e mbrojtjes deri në vitin 2024.

Ajo tha se nëse konfirmohet, do të punonte gjithashtu për t'i nxitur eksportet dhe investimet amerikane në Shqipëri.

Nëse konfirmohet, Yuri Kim do të ishte gruaja e parë koreano-amerikane që përfaqëson ShBA-në në postin e një ambasadori, do të ishte gjithashtu personi i parë nga territori amerikan i Guamit që shërben në një post të tillë.

Yuri Kim është anëtare në stafin e lartë të Shërbimit të Huaj dhe ka shërbyer në Departamentin e Shtetit si drejtore e Zyrës së Çështjeve të Evropës Jugore.

Më herët, ajo ka qenë drejtore dhe Qendres së Departamentit të Shtetit për Studimin e Diplomacisë, shefe e Stafit për zëvendëssekretarin e Shtetit dhe drejtore e Zyrës për Sigurinë Evropiane dhe Çështjeve Politiko-Ushtarake.

Ajo ka qenë gjithashtu asistente speciale e ndihmës sekretarit të Shtetit për Çështjet e Azisë Lindore dhe Paqësorit dhe anëtare e delegacionit të Shteteve të Bashkuara në bisedimet gjashtëpalëshe për t'i dhënë fund programit bërthamor të Koresë së Veriut.

Kim ka shërbyer si këshilltare politike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Bagdad dhe në Ankara.

Ajo ka lindur në Kore dhe është rritur në ishullin Guam, një territor i ShBA-së në Oqeanin Paqësor.

Nëse konfirmohet, Yuri Kim do të ishte gruaja e parë koreano-amerikane që përfaqëson ShBA-në në postin e një ambasadori, do të ishte gjithashtu personi i parë nga territori amerikan i Guamit që shërben në një post të tillë

WASHINGTON, 22 NËNTOR - Komisioni i Senatit për Marrëdhënie me Jashtë miratoi të mërkurën emërimin e diplomates Yuri Kim për postin e ambasadores së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Për t'u bërë zyrtar, emërimi i saj duhet të miratohet nga Senati. Komisioni votoi për 15 emërimet,

përfshirë për të emëruarin për postin e ambasadorit amerikan në Rusi, John Sullivan. Kim, ishte emëruar nga presidenti Donald Trump në qershor të këtij viti.

Në një seancë para Komisionit të Jashtëm të Senatit për konfirmimin e saj në fund të tetorit, ajo tha se do t'i nixte udhëheqësit e

vendit për të zgjidhur ngërçin aktual politik në mënyrë që të forcohet perspektiva e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE, ka njoftuar voa.

Kim shtoi se do të inkurajonte gjithashtu Shqipërinë t'i zbatonte plotësisht reformat në drejtësi, përfshirë kontrollin e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe

krijimin e strukturave të posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ajo tha se shih si përparësi edhe ndihmën teknike për Shqipërinë në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar ndërnacional.

Kim tha gjithashtu se do të inkura-

Meta: Kushtetuta është vija e kuqe e pakalueshme

TIRANË, 22 NËNTOR - Në një konferencë të jashtëzakonshme për mediet, presidenti i Republikës Ilir Meta tha se vija e kuqe është Kushtetuta, ndërsa solli në vëmendje 22 nëntorin që përmes referendumit popullor solli Kushtetutën e re. "Kushtetuta e '98-ës vendosi rotacionin normal politik. Kjo kushtetutë gëzon nderimin e shqiptarëve, por u zhbë në errësirë të plotë nga marrëveshja politike e vitit 2008. Ndryshimet që u bënë në 2016-

ën kanë nxjerrë në pah probleme akute që u paralajmëruan se do të ndodhnin. Kushtetuta u kthye në rregullore me data dhe afate që janë shkelur që të gjitha, që kanë shkaktuar një kaos ligjor që po çon në paralizimin e sistemit të drejtësisë.

Me këto afate një pensionist nuk mund ta gëzojë kurrë pensionin që i takon!", shtoi më tej Meta, teksa tha se si presidenti "do t'iu kundërvihet me të gjitha forcat përpjekjeve të tilla anti-shqiptare".

"Shqiptarët të hapin sytë, të marrin fatin e tyre në dorë, në mbrojtje të Kushtetutës dhe që fëmijët e tyre të mos ikin nga atdheu. Kushtetuta është vijë e pakalueshme nga armiqët e saj. Presidenti do të jetë në mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore të popullit.

Presidenti do të kërkojë mbështetjen e popullit që përmes referendumit të mbrojtë demokracinë që është fituar me vuajtje dhe sakrificë njerëzore", tha Meta.

Presidenti do të bëjë gjithçka që e drejta për referendum të mbrohet. "Të mbrojmë Kushtetutën sot dhe të ardhmen e fëmijëve tanë, Shqipëria e para", përfundoi kreu i shtetit duke bërë simbolin e shqiponjës me dy duar.

Kjo deklaratë e Metës vjen pas ngërçit të krijuar përgjatë javëve të fundit për ngritjen e Gjykatës Kushtetuese. Një ditë më parë vettingu shkarkoi në apel Besnik Muçin, të dekretuarin e Metës si anëtar të Kushtetueses. Po sot kreu i shtetit shpalli sërish



vakancën për anëtarin në Kushtetuese në vend të Muçit, ndërsa ky i fundit nuk e ka pranuar vendimin e vettingut teksa sot shkoi sërish në Gjykatën Kushtetuese. (gsh).

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, janë takuar të premtën për të diskutuar për formimin e koalicionit të përbashkët qeverisës

Marrëveshja LV - LDK, 72 orë pas certifikimit të rezultateve

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, janë pajtuar të premtën që ta kenë marrëveshjen për koalicion qeverisës menjëherë pas certifikimit të rezultateve. Kurti dhe Mustafa pas takimit kanë bërë me dije se marrëveshjen për bashkëqeverisje do ta kenë 72 orë pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ata kanë mohuar se në këtë takim kanë biseduar për ndarje të posteve ministrale apo për postin e presidentit



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, janë takuar të premtën, me ç'rast kanë arritur pajtueshmëri që menjëherë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve ta bëjnë marrëveshjen për qeverinë e ardhshme të

Kosovës. Pas takimit ata kanë deklaruar se ende nuk kanë folur për ndarje të posteve ministrale apo për postin e presidentit të ardhshëm. "Patëm një takim konstruktiv me kryetarin e LDK-së, me ç'rast në të njëjtën kohë kishim edhe takimin e grupeve tona punuese që po harmonizojnë programin e ardhshëm qeverisës. Në këtë takim diskutuam për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe u morëm

vesh që një orë pas certifikimit të rezultateve, shpresojmë e besojmë javën e ardhme, do të takohemi që ta bëjmë marrëveshjen brenda tre-katër ditësh", ka thënë Kurti. Ai është shprehur i bindur se këto dy subjekte politike do ta

arrijnë marrëveshjen brenda 72 orëve pas certifikimit të rezultateve. "Përgjigjja pozitive e kryetarit Mustafa tashmë është dhënë, se një orë pas certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja ne do të takohemi për ta kryer brenda 72 orëve apo më pak se 100 orë marrëveshjen përfundimtare për koalicionin e ardhshëm qeverisës", ka deklaruar lideri i LV-së.

Kurti ka treguar se deri më tani marrëveshja e koalicionit tashmë i ka 26 faqe tekst. "Do t'i vazhdojmë takimet mes grupeve tona punuese për harmonizimin e programit qeverisës i cili deri në këto çaste i ka neto 26 faqe tekst, ku kemi dëshmuar një kulturë të re të formimit të qeverisë. Me fjalë të tjera, u pajtuam për një ritëm të ri", ka deklaruar ai. Edhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka bërë me dije se janë pajtuar që të bëjnë marrëveshje me LV-në menjëherë pas certifikimit të rezultateve. "Patëm një takim me z. Kurti para certifikimit të rezultateve. Vlerësuam punën që është bërë mes ekipeve punuese për harmonizim të programit

qeverisës dhe erdhëm në përfundim se është arritur shumë në këtë aspekt. Në aspektin e numrit të ministrave është arritur pajtueshmëri dhe u pajtuam që porsa të certifikohen rezultatet, të takohemi dhe të merremi vesh për qeverinë e përbashkët mes dy partive tona", është shprehur Mustafa.

Ai ka mohuar se në këtë takim është diskutuar për poste ministrale. "Për poste s'kemi biseduar sot dhe as për ministri konkrete. Biseduam vetëm për atë që të merremi vesh për marrëveshjen për koalicionin tonë katërvjeçar", ka thënë Mustafa. I pari i LDK-së ka folur edhe për partneritetin me Listën Serbe. "Edhe për Listën Serbe edhe për partnerët e tjerë të koalicionit, i mbetet asaj partie që ka kryeministrin të marrë iniciativë dhe t'i thërret të tjerët për qeverisjen e re, edhe LDK-në. Prandaj, dinamika e ardhshme dhe agenda varen nga partia e parë e këtyre zgjedhjeve. Për çështje të ndarjes së ministrave do t'ju njoftojmë pasi t'i bisedojmë ato", ka deklaruar Mustafa.



Daka: Procesi zgjedhor po shkon drejt përmbylljes dhe certifikimit të rezultateve

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Procesi i rinumërimit të votave të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit po shkon drejt fundit. Në Qendrën për Numërim dhe Rezultate nga 1 407 vendvotimeve janë rinumëruar rreth 78 për qind të votave.


Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se pas përfundimit të rinumërimit KQZ-ja është e gatshme ta certifikojë rezultatin e zgjedhjeve. "Pasi që të përfundojë

rinumërimi, sipas vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, më nuk ka afat të ankesave. Pra, është afati i fundit në ditën e fundit të rinumërimit dhe, pas kësaj, nëse nuk kemi ndonjë ankesë tjetër, jemi të gatshëm t'i certifikojmë rezultatet", ka thënë Daka.

Kryetarja e KQZ-së nuk dëshirojë të japë ndonjë datë të saktë se kur do të certifikohet rezultati i zgjedhjeve por, sipas saj, mund të ndodhë që kjo të bëhet javën e ardhshme. "Nuk kisha dashur të

jap ditë apo datë të certifikimit sepse së pari duhet të presim ta përfundojmë rinumërimin dhe pas asaj mund të flasim për data eventuale", u shpreh Daka.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë janë mbajtur më 6 tetor. Lëvizja Vetëvendosje ka fituar më së shumti vota, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Këto parti janë duke zhvilluar takime për formim të qeverisë së re, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror Zgjedhor.





Flet për "Epokën e re", Fatmir Matoshi

AKR-ja NUK PËLQEN TË BËHET PJESË E KOALICIONIT TË ARDHSHËM QEVERISËS

Kryetari i Kuvendit të Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka treguar se ky subjekt politik pritet të jetë në opozitë gjatë legjislaturës së shtatë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo parti nuk pëlqen të bëhet pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës. Sipas tij, të qenit në opozitë gjatë mandatit të ardhshëm do t'i mundësojë kësaj partie që t'i bëjë reformat e nevojshme brendapartiake. Matoshi është shprehur i bindur se në këtë mënyrë do të rritet përkrahja e qytetarëve të Kosovës ndaj AKR-së ashtu siç janë duke u fuqizuar partitë liberale në Evropë

bazuar çdoherë në rrethanat politike të vendit", ka thënë ai. Matoshi, i cili është ministër në detyrë i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka folur edhe për mundësinë e funksionimit të koalicionit Nisma-AKR-PD pas konstituimit të Kuvendit. Ai ka treguar se Nisma dhe AKR-ja janë parti me ideologji të ndryshme, por kjo nuk do të thotë se ato mund të bashkëpunojnë. "Ne jemi dy parti që funksionojmë ndaras dhe me ideologji të kundërta, por kjo nuk do të thotë që ne nuk do të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen. Ne kemi pasur një bashkëpunim të mirë edhe gjatë mandatit të kësaj qeverie dhe për të mirën e vendit do të bashkëpunojmë çdoherë", ka thënë Matoshi.

Më tej, Matoshi ka vlerësuar se LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i formojnë institucionet e reja menjëherë pas certifikimit të rezultatit zgjedhor.

Sipas tij, qytetarët e Kosovës më 6 tetor kanë votuar për ndryshim dhe kjo duhet të merret parasysh nga të gjithë. "Partia fituese e ka obligim që pa vonesa t'i krijojë institucionet shtetërore për t'i vazhduar proceset politike të vendit. Siç e dini, ne si AKR në vitin 2017 kemi bërë thirrje dhe kemi ofruar përkrahjen tonë për opozitën që t'i tejkalojnë barrierat dhe të bashkohen për krijimin e koalicionit qeverisës, por kjo nuk ndodhi. Shpresojmë që me situatën e re të krijuar pas zgjedhjeve të mos kemi vonesa për konstituimin e institucioneve shtetërore", është shprehur Matoshi.

"Epoka e re": Z. Matoshi, në Qendrën e Numërimit të Rezultateve është duke vazhduar rinumërimi 1 407 kutive të votimit me vendim të PZAP-it. Ky proces a do ta bëjë përfundimisht koalicionin Nisma-AKR-PD pjesë të

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se kjo parti nuk preferon të bëhet pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës. Ai ka deklaruar se AKR-ja mendon të jetë opozitë në legjislaturën e shtatë dhe t'i gjejë gabimet që kanë sjellë rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Matoshi ka deklaruar se AKR-ja, duke qenë në opozitë, do t'i bëjë reformat e nevojshme në parti dhe prezantimin e duhur të ideologjisë liberale në vend. "AKR-ja, duke mos qenë e kënaqur me rezultatin e treguar në zgjedhjet e fundit parlamentare, nuk pëlqen të jetë pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës. Në vend të kësaj preferojmë t'i gjejmë gabimet që kemi bërë, t'i bëjmë reformat e

nevojshme në parti, ta bëjmë prezantimin e duhur të ideologjisë liberale në vend, e cila ideologji i duhet Kosovës", ka thënë Matoshi. Ai është shprehur i bindur se vetëm në këtë mënyrë qytetarët e Kosovës do të përkrahin këtë parti ashtu siç janë duke u fuqizuar partitë liberale në Evropë. "Të gjitha vendimet për të ardhmen e partisë dhe bashkëpunimet eventuale do të merren nga organet udhëheqëse dhe duke u



KDI-ja: Kuvendi i ri ta ketë prioritet miratimin e rregullores së re të punës

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka lansuar të premten platformën e dialogut "Kuvendi 2020". Në funksion të kësaj, KDI-ja ka publikuar analizën e shkurtër "Tejkalimi i sfidave të Kuvendit përmes miratimit të Rregullores së re të Punës". Sipas KDI-së, miratimi i kësaj rregullore përbën një mundësi unike për legjislaturën e re që t'i trajtojë me prioritet disa mangësi që e kanë përcjellë punën e Kuvendit në vitet e kaluara

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Në pritje të certifikimit të rezultateve nga zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit 2019 dhe formimit të institucioneve të reja, Instituti Demokratik të Kosovës (KDI) të premten ka lansuar platformën e dialogut "Kuvendi 2020", në mes të përfaqësuesve politikë dhe shoqërisë civile, me qëllim që ta rrisë debatin mbi transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e institucionit të Kuvendit. Në funksion të kësaj, KDI-ja ka publikuar analizën e shkurtër "Tejkalimi i sfidave të Kuvendit përmes miratimit të Rregullores së re të Punës". Sipas KDI-së, miratimi i Rregullores së re të Punës përbën një mundësi unike për legjislaturën e re që t'i trajtojë me prioritet disa mangësi që e kanë përcjellë punën e Kuvendit në vitet e kaluara.

Platforma 2020 do të jetë në funksion të trajtimit edhe të disa temave të tjera në interes të publikut dhe qeverisjes së mirë si: Reforma zgjedhore, Ligji për financimin e subjekteve politike, Ligji për lobimin dhe konsensusi për dialogun Kosovë - Serbi njofton "Klan Kosova". "Në dy legjislaturat e fundit Kuvendi ka çaluar në organizimin e punës, gjë që është përkthyer në performancë të dobët të këtij institucioni. Kryesia e Kuvendit nuk është mbledhur me rregull për të caktuar seanca plenare. Shmangiet nga procedurat e parapara në Rregulloren e

Punës për shqyrtimin e projektligjeve kanë qenë të shpeshta, ndërsa mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare nuk janë ushtruar në mënyrë efektive. Deputetët kanë abstenuar nga ushtrimi i mandatit të tyre kushtetues, duke mos marrë pjesë në seanca dhe mbledhje të komisioneve, si dhe duke mos marrë pjesë në votim përkundër që kanë qenë të pranishëm në seancë", është thënë në raportin e KDI-së, duke shtuar se rregullorja e re do të mund të adresonte shumë çështje teknike. "Të gjitha këto mangësi kërkojnë vëmendje dhe zgjidhje praktike nga deputetët e ardhshëm të Kuvendit, i cili pritet të ketë rreth 50 deputetë të zgjedhur për herë të parë. Rregullorja e re do të mund të adresonte shumë çështje teknike dhe do ta rriste përkushtimin, disiplinën dhe efikasitetin e Kuvendit në ligjëbërje, përfaqësim dhe mbikëqyrje", është thënë në raport.

Alexander Chavarria nga NDI-ja ka theksuar se është e rëndësishme dhe urgjente që të ketë një rregullore të re të punës. Sipas tij, është shumë me rëndësi që Kuvendi të sigurohet që qeverisja në të gjitha nivelet të jetë transparente, llogaridhënëse dhe e përgjegjshme.

Chavarria ka thënë se duhet të kuptohet që janë bërë 10 vjet prej kur është miratuar Rregullorja e Punës e fundit, ndërsa ka theksuar nevojën për rishikim të saj në mënyrë që ajo t'i adaptohet kontekstit politik. Ai ka theksuar

se ekziston një dokument i mirëkonsoliduar në Kuvend dhe, sipas tij, jo doemos duhet të ketë vonesa në drejtim të rregullores së re.

Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje ka theksuar se prioriteti i Kuvendit të ri duhet të jetë rregullorja e re në mënyrë që të shmangen pengesat që kanë shoqëruar legjislaturat e kaluara. Haxhiu ka thënë se pajtohet që legjislatura e fundit nuk ka pasur performancë të mirë dhe se përgjegjësinë e ka kryesia e Kuvendit. Sipas saj, ka pasur organizim të çrregullt të punës në përgjithësi teksa ka thënë se krahas kësaj një pjesë e komisioneve parlamentare kanë bërë punë të mirë. Haxhiu ka theksuar se duhet të ndodhë fuqizimi i rolit të Kuvendit, mekanizmave të tij dhe pa dyshim edhe fuqizimi i rolit të opozitës. "Qasja e rregullores nuk duhet të jetë shtypja e opozitës, por fuqizimi i saj dhe i Kuvendit", ka shtuar ajo.

Armend Zemaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka thënë se Kuvendi nuk ka arritur që nga legjislatura e tretë ta miratojë rregulloren e re dhe se tani duhet të shihet se si të arrihet konsensusi politik për të. Zemaj ka theksuar se më e rëndësishmja është që të avancohet me demokratizimin e mëtejshëm të raporteve në të gjitha instancat e Kuvendit, funksionalizimin e organeve të Kuvendit, racionalizimin e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe racionalizimin kohor. Dy legjislaturat e fundit, sipas tij, kanë lënë shumë për të dëshiruar në çdo aspekt.

Kuvendit të Kosovës?

Matoshi: Si parti dhe si koalicion kemi thënë që nga 6 tetori se e kemi kaluar pragun dhe kjo u rikonfirmuar edhe tani pas tejkalimit të situatave dhe pretendimeve për deformimin e vullnetit të qytetarëve të vendit. Ne tani po presim edhe përfundimin e rinumërimit të votave dhe besojmë se pas certifikimit të rezultateve finale koalicioni ynë do të jetë pjesë e Kuvendit të Kosovës.

"Epoka e re": Në bazë të rezultatit që po nxjerr procesi i rinumërimit, sa deputetë do t'i ketë AKR-ja në Kuvend?

Matoshi: Momentalisht kemi të konfirmuar dy deputetë, presim ta kemi edhe deputetin e tretë.

"Epoka e re": Nëse ky koalicion është pjesë e Kuvendit të Kosovës, a është diskutuar në mes liderëve partiakë se cili do të jetë fati i këtij koalicioni në Kuvend? Do të veproni si koalicion apo do të veproni si parti të ndara?

Matoshi: Ne jemi dy parti që funksionojmë ndaras dhe me ideologji të kundërta, por kjo nuk do të thotë që ne nuk do të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen. Ne kemi pasur bashkëpunim të mirë edhe gjatë mandatit të kësaj qeverie dhe për të mirën e vendit do të bashkëpunojmë çdoherë.

"Epoka e re": Cilat janë gjasat që AKR-ja të jetë pjesë e koalicionit qeverisës?

Matoshi: AKR-ja, duke mos qenë e

kënaqur me rezultatin e treguar në zgjedhjet e fundit parlamentare, nuk pëlqen të jetë pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës. Preferojmë që t'i gjejmë gabimet që kemi bërë, t'i bëjmë reformat e nevojshme në parti, ta bëjmë prezantimin e duhur të ideologjisë liberale në vend e cila i duhet Kosovës dhe jemi të bindur që qytetarët do ta përkrahin dhe do ta fuqizojnë liberalizmin ashtu siç janë duke u fuqizuar partitë liberale në Evropë. Të gjitha vendimet për të ardhmen e partisë dhe bashkëpunimet eventuale do të merren nga organet udhëheqëse dhe duke u bazuar çdoherë në rrethanat politike të vendit.

"Epoka e re": Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK-ja janë në prag të arritjes së marrëveshjes për koalicionin qeverisës. Sa besoni se do të funksionojë një qeverisje në mes të këtyre dy partive?

Matoshi: Qytetarët kanë votuar për ndryshim dhe kjo duhet të merret parasysh nga të gjithë. Partia fituese e ka obligim që pa vonesa t'i krijojë institucionet shtetërore për t'i vazhduar proceset politike të vendit. Siç e dini, ne si AKR në vitin 2017 kemi bërë thirrje dhe kemi ofruar përkrahjen tonë për opozitën që t'i tejkalojnë barrierat dhe të bashkohen për krijimin e koalicionit qeverisës, por kjo nuk ndodhi. Shpresojmë që me situatën e re të krijuar pas zgjedhjeve të mos kemi vonesa për konstituimin e institucioneve shtetërore.



Hapet aplikimi për grante të vogla për turizëm në Kamenicë



KAMENICË, 22 NËNTOR (ER) - Projekti "Rikthimi i prosperitetit përmes turizmit dhe trashëgimisë kulturore", i cili është duke u realizuar nga organizata joqeveritare "Proactive" në bashkëpunim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë (DZHEH) në Kamenicë, ka njoftuar qytetarët se ka përfunduar me sukses seria e takimeve informuese me banorët e fsha-

trave Tugjec, Kranidell, Poliçkë, Lisockë dhe Zajçec. Ky projekt synon të krijojë të ardhura për ekonomitë familjare në zonat e Malësisë në Komunën e Kamenicës nëpërmjet turizmit rural. "Dhjetëra qytetarë që kanë qenë të pranishëm nëpër këto takime kanë pranuar aplikacione për grante dhe për trajnime, të cilat duhet t'i dorëzojnë deri më datë 29 nëntor 2019 në objektin e Komunës së

Kamenicës, te Zyra e Turizmit pranë DZHEH-së, apo mund t'i dërgojnë edhe përmes e-mail adresës proactivekos@gmail.com. Gjithashtu, për të gjithë të interesuarit e tjerë që nuk kanë mundur të marrin pjesë në këto takime mund të kontaktojnë në numrin 049 368 663 ('viber' dhe 'whatsapp') për informata shtesë dhe takime të drejtpërdrejta", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

Fillojnë punimet për projektin e poligonit multifunksional sportiv dhe parkingjeve në Skenderaj

SKENDERAJ, 22 NËNTOR (ER) - Kanë filluar punimet për projektin e poligonit multifunksional sportiv dhe parkingjeve në Komunën e Skenderajt.

Kryetari i kësaj komune, Bekim Jashari, së bashku me drejtoreshën e Urbanizimit dhe bashkëpunëtorë, kanë marrë pjesë në fillimin e punimeve në poligonin multifunksional sportiv ku, përveç poligonit multifunksional, aty do të ndërtohen edhe 258 vendparkingje. Ky projekt është mjaft i rëndësishëm për



dashamirët e sportit dhe rinisë së Skenderajt të cilët do ta kenë një vend të mrekullueshëm për t'i zhvilluar lojërat e tyre që i pëlqejnë. Po ashtu, kjo hapësirë do të bëhet edhe më e bukur me vendparkingje të mjaftueshme që do të ndërtohen për qytetarët.

Vihet gurthemeli i shkollës fillore në Gushavc të Mitrovicës

MITROVICË, 22 NËNTOR (ER) - Në fshatin Gushavc të Mitrovicës të premtën është vënë gurthemeli për ndërtimin e objektit të ri të shkollës fillore "Harun Beka", projekt ky i cili kap shumën 1 milion e 300 mijë euro.

Në vënien e gurthemelit të kësaj shkolle ishte i pranishëm kryetari i komunës, Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Hysen Muzliukaj, zyrtarë komunalë si dhe banorë të këtij fshati. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka uruar nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për fillimin e ndërtimit të kësaj shkolle të re, duke theksuar se gjithmonë prioritet e ka pasur ngritjen e cilësisë së arsimit në qytetin e Mitrovicës.

Kryetari Bahtiri ka falënderuar



edhe MASHT-in për mbështetjen e dhënë për bashkëfinancimin e këtij projekti. Ai ka bërë me dije se me ndërtimin e

kësaj shkolle do të krijohet ambient më i përshtatshëm dhe do të plotësohen nevojat për mësimdhënie dhe mësimxënie.

Revitalizohet shtegu që lidh parkun e Gërmisë me liqenin e Badocit

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se tani e tutje të gjithë adhuruesit e natyrës, sportit dhe alpinizmit kanë mundësinë të ecin, vrapojnë e çikëlojnë nëpër shtegun që lidhë Parkun e Gërmisë me "Pyllin e Arinjve" e liqenin e Badocit.

Kjo komunë ka theksuar se ky shteg është financuar nga projekti ADA/RESI. "Revitalizimi dhe shenjëzimi i shtegut të

gjatë prej 5.5 kilometrash gjatësi është bërë në bashkëpunim me Klubin Alpin Prishtina dhe është financuar nga projekti i ADA/RESI, të cilët i falënderojmë shumë. Parku i Gërmisë, me 1 949 hektarë, ka florë e faunë të pasur, ajër të pastër dhe është vend ideal për shumë sporte dhe shëtitje në çdo stinë, në natyrën e bukur që e ka", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Shpërndahen 350 kontejnerë në fshatin Koshtovë të Mitrovicës

MITROVICË, 22 NËNTOR (ER) - Në kuadër të zbatimit të planit komunal për menaxhim të mbeturinave, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit ka bërë shpërndarjen e rreth 350 kontejnerëve me kapacitet 120 litra, për ekonomi familjare në

fshatin Koshtovë të Mitrovicës. Drejtori për Mbrojtje të Mjedisit, Asllan Isufi, është shprehur mjaft i kënaqur me realizimin e projekteve që po bëhen në të mirë të qytetarëve. Projekti i cili është implementuar në fshatin Koshtovë është realizuar

me kërkesë nga Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit si dhe është mbështetur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kjo drejtori ditë më parë ka përmbyllur me sukses procesin e ndarjes

së rreth 600 kontejnerëve, me kapacitet 240 litra, i cili ishte një pilotprojekt donacion nga GIZ-i gjerman, të cilët do të shërbejnë për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në lagjen "Ilirida" në qytetin e Mitrovicës.



Thaçi: Emancipimi i gruas në Kosovë është emancipim i tërë shoqërisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë të premtën në lansimin e Studimit mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë, të organizuar nga OSBE-ja.

Presidenti Thaçi ka thënë se pas pranimit të raportit ndjenja e parë është ajo e dëshpërimit me pozitën e gruas, me dhunën që ushtrohet kundër gruas, me kërcënimet për mirëqenien dhe sigurinë e tyre në shoqërinë e Kosovës. Sipas tij, traumat e thella të luftës dhe gjenocidit, të represionit dhe të diskriminimit, të përjashtimit dhe mohimit të të drejtave, prekin thellë në shoqërinë tonë. "Prekin edhe pozitën e gruas dhe mundësinë e tërë shoqërisë për t'u përballur me problemet më të thella dhe më të rëndësishme", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i vendit ka shtuar se po në këtë raport ka gjetur arsye edhe për optimizëm dhe kurajë për të vazhduar zhvillimin dhe transformimin e shoqërisë së Kosovës. Ai ka përmendur tri të arritura të rëndësishme të këtij raporti. "E arritura e parë është se edhe Kosova është përfshirë në këtë studim të rëndësishëm", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se është "i vetëdijshëm për pengesat që i bëhen shtetit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare".

Presidenti ka thënë se nuk dëshiron të flasë sa e padrejtë është kjo ndaj qytetarëve të Kosovës, por ka shprehur mirënjohje për

përfshirjen e Kosovës në këtë hulumtim. "Ju jam mirënjohës që keni vënë të drejtat dhe liritë e individit, qytetarit të Kosovës, mbi çdo politikë të ditës e interes të grupeve apo shteteve të ndryshme", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se e arritura e dytë është se anketa e publikuar nuk bën vetëm konstatimin e gjendjes, por kërkon shkaqet, analizon shkaqet dhe pasojat si dhe jep rekomandime për ta përmirësuar gjendjen. "Mostra e respondentëve, pyetjet, intervistat kanë nxjerrë në pah të dhëna që kërkojnë debat e diskutime thelbësore në shoqërinë e Kosovës. Për më tepër, anketa që po e publikoni sot nuk bën vetëm konstatimin e gjendjes, por kërkon shkaqet, analizon shkaqet dhe pasojat si dhe jep rekomandime për ta përmirësuar gjendjen. Po flasim për përmirësimin e pozitës së gruas në Kosovë për fuqizimin e saj", ka shtuar presidenti.

Emancipimi i gruas në Kosovë ai ka thënë se do të thotë emancipim i tërë shoqërisë. "Fuqizimi i gruas në Kosovë do të thotë fuqizim i parimeve të lirisë, barazisë, dinjitetit që vlejnjë për tërë shoqërinë tonë", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se "me punën tuaj ju po ndihmoni debatin e përgjithshëm shoqëror në Kosovë dhe emancipimin e tërë shoqërisë".

I pari i vendit ka thënë se duke organizuar konferenca të tilla mbahet në majë të agjendës çështja e barazisë gjinore dhe nevoja për fuqizim të gruas. "Të dhënat që do të shpalosni sot këtu do të kontribuojnë për një



debat më të argumentuar. Rekomandimet tuaja do të ndihmojnë në ndërmarrjen e hapave për ta përmirësuar pozitën e gruas në shoqërinë e Kosovës. Është e vërtetë që, pavarësisht prej sfidave dhe historisë sonë, kemi bërë hapa të

mëdhenj përpara për fuqizimin e gruas dhe avancimin e rolit të saj në shoqëri. Por, ky është vetëm fillimi", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka shtuar se kemi ende rrugë për të bërë për të garantuar barazi të plotë gjinore në shoqërinë e Kosovës. "Me

përkushtimin, me njohuritë tona dhe përkrahjen tuaj do të vazhdojmë të ecim përpara derisa çdo grua, çdo vajzë të ndihet e barabartë në shoqërinë tonë. Të ndihet e sigurt, e pranuar, e mbrojtur, e barabartë dhe e lirë", ka thënë presidenti Thaçi.

Qeverisja lokale ballafaqohet me kapacitete të vogla financiare

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Komunitet e Kosovës nuk kanë kapacitete financiare, prandaj kërkohet një ndryshim rrënjësor në lidhje me qasjen në politikën fiskale. Kështu është thënë të premtën në konferencën "Vetëqeverisja lokale në Kosovë - 20 vjet".

Drejtoresha e misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, ka thënë se Kosova në këta 20 vjet ka punuar për krijimin e institucioneve të veta dhe se këtij shteti i duhet një qeverisje e mirë. Sipas saj, e ardhmja e Kosovës nuk varet



vetëm nga qeveria, por edhe nga qytetarët. Në këtë kontekst, Magno ka thënë se Kosova ka nevojë për edukim më të madh të të rinjve dhe grave. Ajo ka folur për aktivitetin e

aktivistëve të programit për transformimin e lidershit që, sipas saj, do të ndikojnë në rritjen e transparencës institucionale.

Ndërsa Auditori i Përgjithshëm,

Besnik Osmani, ka vlerësuar se një prej sfidave kryesore në qeverisje lokale janë paqartësitë e kompetencave midis pushtetit qendror dhe atij lokal. Sipas tij, sfida tjetër për qeverisje lokale

mbetet edhe plakja e stafit, për çka ka kërkuar nga udhëheqësit e këtyre pushteteve të ofrojnë zgjidhje. Sipas Osmanit, për ngritje të efikasitetit të pushtetit lokal nevojitet përdorimi më i madh i digitalizimit dhe zvogëlimi i administratës. Osmani ka thënë se është e nevojshme edhe reforma zgjedhore me qëllim që kryetarët e komunave të zgjedhjen me një raund zgjedhor. Të pranishëm në këtë konferencë ishin kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ai i Hanit të Elezit, Rufki Suma dhe kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati.

Vendosen shenjat orientuese në hapësirat e QKUK-së

Prishtinë, 22 nëntor (ER) - Të gjithë vizitorët që kishin probleme për t'u orientuar në Qendrën Klinike Universitare tash e tutje do ta kenë më të

lehtë ngaqë në rrugët kryesore të saj janë vendosur shenjat për secilin klinikë dhe institucion brenda oborrit të QKUK-së. Më herët pacientët kanë

humbur shumë kohë duke bredhur rrugëve në pamundësi për ta gjetur vendin e saktë për institucionet përkatëse shëndetësore.

Implementimi i këtij projekti i ka dhënë një pamje tjetër QKUK-së, ndërsa pacientëve qasje më të lehtë për marrje të shërbimeve.



Me protestë kundërshtohet vendimi i BQK-së për shtrenjtimin e sigurimeve

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Para Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) me dhjetëra qytetarë kanë protestuar të premten për ta kundërshtuar vendimin e BQK-së për shtrenjtimin e sigurimeve të automjeteve për 26 për qind. Me pankarta në duar, para BQK-së protestuesit kanë bërë thirrje për shfuqizim të këtij vendimi pasi, sipas tyre, në këtë mënyrë ata do të dëmtohen.

Agan Hajdarhoxha nga grupi i "Meraklive të kerreve" ka thënë se po kërkojnë që të kthehet çmimi i mëparshëm. "Ne nuk po kërkojmë të lirohet siguri, por

të kthehet vendimi i vjetër siç ka qenë. Kërkoj nga ky institucion që të marrë sa më shumë masa që ta kthejë vendimin e vjetër. Për t'u regjistruar një veturë standarde duhen minimumi 300 euro. Rroga mesatare nuk e kalon shumën 230 euro. Imagjinojini si do ta kalojë muajin një qytetar", ka thënë ai.

Pas protestës, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, i ka ftuar në takim organizatorët e kësaj proteste.

Agan Hajdarhoxha ka thënë se me përfaqësuesit e BQK-së janë pajtuar që ditën e hënë t'i dorëzojnë gjashtë kërkesa për të cilat do të marrin përgjigje brenda tre

ditësh. "Pas një takimi mjaft të gjatë ne u pajtuam që ditën e hënë t'i dorëzojmë gjashtë kërkesa të protokolluara. Ata na premtuan se do të marrim përgjigje brenda tri ditësh për secilën përgjigje veç e veç. Nëse nuk plotësohen gjashtë kërkesat tona, do t'i vazhdojmë protestat derisa të plotësohen të paktën tri prej tyre", ka thënë Hajdarhoxha.

Protestuesit kanë kërkuar pezullimin ose kthimin e menjëhershëm të vendimit për sigurimin e veturave, shqyrtimin e vendimit të ri të BQK-së, zhvillimin e një ankete me qytetarët, qasje në diskutimet midis BQK-së dhe kompanive të sigurimeve dhe mos të merren vendime pa dijeninë e qytetarëve.

Për rritjen e sigurimit, Haradinaj i kërkon BQK-së arsyet e vendimit

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, përmes një letre zyrtare ka kërkuar nga guvernatori i Bankës Qendrore, Fehmi Mehmeti, informacione mbi arsyeshmërinë dhe faktorët mbi vendimin e rritjes së tarifave për regjistrimin e automjeteve për 26 për qind. "Pas vendimit për rritjen e tarifave për regjistrimin e automjeteve për 26 për qind dhe pas reagimeve të shumta të qytetarëve, sot i jam drejtuar guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, me kërkesën për një informatë të detajuar mbi arsyeshmërinë dhe faktorët në bazë të të cilave është marrë ky vendim", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



ATK-ja vazhdon ta konfiskojë pasurinë e tatimpaguesve borxhlinj

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) edhe gjatë kësaj jave ka zhvilluar aksion në disa lokacione të ndryshme për konfiskimin e pasurisë së tatimpaguesve të cilët nuk kanë përmbushur kërkesat ligjore të ATK-së në pagesën e borxheve në afatin e përcaktuar si dhe nuk u janë përgjigjur paralajmërimeve të ATK-së se do të ndërmerren veprimet e mbledhjes së detyrueshme të tatimeve përmes konfiskimit të pasurisë. Procedura e konfiskimit, në

bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është zhvilluar ndaj gjashtë tatimpaguesve sipas planit paraprak, ndërsa vlera e mallrave dhe pasurisë së konfiskuar është 500 000 euro. "Si rezultat i shumë aktiviteteve intensive që administrata tatimore është duke ndërmarrë, kemi trend pozitiv të zvogëlimit të borxheve të cilat kanë reflektuar në rritjen e të hyrave. Përveç konfiskimit të pasurisë, aksioni në fjalë do të shtrihet edhe në mbledhjen e të gjitha gjobave



mandatore të cilat janë të papaguara", është bërë me dije në njoftimin e ATK-së. Sipas këtij njoftimi, aksionet e

ngjashme do të vazhdojnë edhe gjatë ditëve në vijim, andaj inkurajojmë të gjithë tatimpaguesit borxhlinj që t'i kryejnë me kohë obligimet tatimore, në mënyrë që të mos bëhen objekt i ndëshkimeve dhe i procedurave të mbledhjes së detyrueshme. "Fokusi ynë vazhdon të mbetet rritja e nivelit të përmbushjes vullnetare të tatimpaguesve sipas Legjislacionit Tatimor të Kosovës si dhe trajtimi i borxheve tatimore", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Oda Amerikane me aktivitete inspiruese për të rinjtë



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Të rinjtë e Kosovës duhet të mësojnë për sa më shumë rrëfime suksesi të ndërmarrësve kosovarë të cilët me gjithë vështirësitë para dhe pas luftës ia kanë dalë të krijojnë ndërmarrje të cilat sot punësojnë me qindra persona, ndërsa rol të rëndësishëm këtu luan edhe edukimi i mirëfilltë. Me katër aktivitete të ndryshme të organizuara brenda një dite, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka vazhduar shënimin e Javës Globale të Ndërmarrësisë që organizohet nën udhëheqjen e Qendrës së Inovacionit të Kosovës.

Për ngjarjen e titulluar "Të zhvillohesh në Kosovë", Hakif Gashi, pronar i "Meridian Corporation", njëherësh edhe ndërmarrës jashtëzakonisht i suksesshëm, ndau rrugëtimin e tij që nga viti 1992 e deri më sot duke diskutuar

mbi sfidat dhe mundësitë e zgjerimit të aktiviteteve ndërmarrëse në vend.

Gashi ka potencuar se pasioni i madh dhe përpjekjet e vazhdueshme kanë qenë faktorë kyç për rritjen e korporatës të cilën ai e udhëheq. Për më tepër ai ka treguar se për të qenë një ndërmarrës i suksesshëm dhe bashkëkohor duhet që në mënyrë konstante të punohet për ofrimin e produkteve me kualitet të lartë që e rrisin mirëqenien e shoqërisë.

Në tryezën e organizuar në Drenas, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Rajonal - Qendër dhe Komunën e Drenasit, të titulluar "Të bëhesh ndërmarrës: perspektivat e vetëpunësimit", ku ndërmarrësi Mërgim Prishtina ndau me të rinjtë e Drenasit historinë e krijimit të kompanisë "TrePharm", duke theksuar se ka zgjedhur të investojë në industrinë farmaceutike, duke e parë si industri që mungon në

vend. Ai i ka inkurajuar të rinjtë të merren me biznes.

Drejtoresha ekzekutive e AZHR - Qendër, Mrika Macula, ka theksuar se në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë, Agjencia për Zhvillim Rajonal - Qendër po punon drejt trajnimit të të rinjve në aftësi të buta si dhe këshillimin e ndërmarrësve për aplikim në grante.

Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se fuqizimi i ndërmarrësisë nënkupton edhe fuqizimin e shtetit dhe se të rinjtë kosovarë me përkrahjen e gjithanshme brenda dhe jashtë institucionale duhet të krijojnë perspektivë për të tashmen dhe të ardhmen e tyre me anë të ndërmarrësisë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka pohuar se qëllimi i kësaj organizate për këtë javë është që me të rinjtë e Kosovës të ndajë sa më shumë histori inkurajuese të suksesit. Ai u shpreh se sot në Kosovë

ekzistojnë rrethana më të favorshme për të qenë ndërmarrës, ndërsa sektori privat ofron mundësitë më të mëdha për zhvillimin e karrierës.

Zeka i ka inkurajuar të rinjtë e pranishëm që nga tani ta fillojnë caktimin e synimeve të tyre, në mënyrë që në të ardhmen të kontribuojnë për shoqërinë.

Oda Amerikane, në bashkëpunim me kolegjin RIT Kosovo, organizoi ngjarjen "Nxitja e ndërmarrësisë përmes edukimit", ku ndërmarrësi shumë i suksesshëm Ardian Hoxha ndau me studentët e RIT Kosovo ndikimin e edukimit në rrugëtimin e tij si ndërmarrës. Hoxha i motivoi studentët me rrëfimin e tij, duke u fokusuar në faktin se suksesi është i arritshëm për çdo person që beson se mund t'ia dalë, natyrisht duke i caktuar objektivat dhe duke punuar shumë për t'i arritur ato. Ai i ka inkurajuar studentët që ta fillojnë përfshirjen në punë, qoftë ajo edhe vullnetare, pasi në këtë

mënyrë ata do të fitojnë sa më shumë përvojë mbi tregun e punës dhe do t'i rrisin aftësitë e tyre.

Aktivitetet me shumë interes dhe interaksion të madh ishte ai i organizuar nga Oda Amerikane në bashkëpunim me ndërmarrësin Ardian Hoxha "A mund të jesh kampion i suksesit?" me qëllim të diskutimit të sfidave nëpër të cilat kalojnë ndërmarrësit e suksesshëm, me përvojë në fusha të ndryshme.

Mbi 200 të rinj të pranishëm patën mundësi të mësojnë për përvojat e ndërmarrësve si Ardian Hoxha, Hana Qerimi nga Shkolla Digjitale, Arta Shehu-Zaimi nga Labbox si dhe Mërgim Prishtina nga kompania "TrePharm". Të katër ndërmarrësit e rinj rrëfyan para audiencës përvojat e tyre nga hapja e biznesit e deri në zhvillimin e bizneseve të tyre, duke përmendur sfidat që i kanë kaluar dhe arritjet e vazhdueshme të tyre.

Këshilli i Investitorëve Evropianë mbështet BQK-në për çmimet e sigurimeve

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Këshilli i Investitorëve Evropianë (KIE) mbështet veprimet e BQK-së për ruajtjen e stabilitetit financiar nga ana e tregut të sigurimeve duke potencuar se sektori i sigurimeve përbën një shtyllë shumë të rëndësishme të sistemit financiar, të mirëqenies së qytetarëve si dhe zhvillimit ekonomik. Gjithashtu, KIE mbështet edhe rritjen e tarifës pasi që ky veprim ka për qëllim mbështetjen e policëmbajtësit dhe zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori. "Sektori i sigurimeve ka një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e përgjithshme duke mobilizuar kursimet e brendshme dhe mundëson zbutjen e humbjeve, stabilitetin financiar dhe promovon aktivitetet e



tregtisë duke rezultuar në rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Në dokumentin vjetor të publikuar nga Këshilli i Investitorëve Evropianë 'White Book' është potencuar se sektori financiar, në veçanti sektori i sigurimeve, ka nevojë për mbështetje dhe zhvillim të mëtutjeshëm, duke konsideruar

se ky sektor në Republikën e Kosovës ende mbetet i pazhvilluar. Industria e Sigurimeve në Kosovë konsiderohet e pazhvilluar", është theksuar në reagimin e KIE-s.

Sipas Këshillit të Investitorëve Evropianë, sektori i sigurimeve përfaqëson vetëm 3 për qind të sektorit financiar. "Për më tepër,

dy tregues kryesorë tregojnë se Penetrimi (Primi i shkruar/BPV i vlerësuar të jetë 1.4 për qind i BPV-së, si dhe Dendësia 44 euro për frymë, këta dy tregues janë më të ulët në rajon, ndërkohë që mbeten larg nga mesatarja e BE-së. Për më shumë vlerësohet se ka një numër të lartë të automjeteve të paregjistruara dhe të

pasiguruara që marrin pjesë në mënyrë aktive në trafik. Kontraktimi i sigurimit të autopërgjegjësive ndaj palëve të treta dhe regjistrimi i automjetit është i detyrueshëm me ligj", thuhet në këtë reagim.

Këshilli i Investitorëve Evropianë ka mbështetur fuqishëm të gjitha përpjekjet për ta rregulluar dhe zhvilluar sektorin financiar, sidomos atë të sigurimeve pasi, siç thuhet, "ky sektor ka ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin ekonomik drejtpërdrejt, por edhe në rritjen e investimeve të reja vendore dhe të huaja. Gjithashtu, KIE mbështet edhe rritjen e tarifës pasi që ky veprim ka për qëllim mbështetjen e policëmbajtësit dhe zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori".

Betimi i Hipokratit dhe fytyra e hipokritit (2)

Ekipi mjeko-ligjor zviceran nuk pajtohet me ekipin mjeko-ligjor të Kosovës rreth diagnozës së vdekjes së Astrit Deharit



**Shkruan: Bardhyl
MAHMUTI**

Pretendimi i Flamur Blakajt, se e paskëshin "kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme" dhe se gjoja mendimi i ekspertëve zviceranë dhe i Komisionit Mjekësor të Kosovës "përputhen në pjesën dërrmuese", është një gënjeshtër e kulluar.

Raportet e ekspertizës zvicerane jo vetëm që nuk përputhen në pjesën dërrmuese të konstatimeve me raportin e autopsisë të kryer nga ekipi mjeko-ligjor i Kosovës por, përkundrazi, nuk mund të gjendet asnjë pikë e vetme, ku përputhen qasjet e të dy ekipeve mjeko-ligjore.

1. Ekipi mjeko-ligjor zviceran nuk pajtohet me ekipin mjeko-ligjor të Kosovës rreth diagnozës së vdekjes së Astrit Deharit, sipas të cilëve ai "kishte vdekur si pasojë e asfiksionit mekanik nga bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes nga një mjet me konsistencë solide (i fortë) dhe se shkaktimi i vdekjes mund të shpjegohet me ndaljen e menjëhershme të punës së zemrës". Ekspertiza zvicerane nxori në shesh një numër të konsiderueshëm mangësish të ekipit mjeko-ligjor të Kosovës në interpretimin e plagëve të shaktuara nga shishja plastike në gojë dhe erdhjen e përfundimi i ndryshëm, që hap rrugën e hulumtimit të mekanizmave të tjerë të përdorur për t'i zënë frymën Astrit Deharit. Një ndër mekanizmat e tjerë që përmendin ekspertët zviceranë, e që ka të bëjë me procesin fatal të zënies së frymës, lidhet me

mavijosjet që vërehen në vendet karakteristike për lëndimet, që janë shkaktuar gjatë kapjes në qafë, të llojit "çelësi i krahut" ose formave të tjera të dhunës në qafë.

Ekspertët zviceranë hodhën poshtë diagnozën e ekipit mjeko-ligjor të Kosovës edhe për gjoja "ndaljen e menjëhershme të punës së zemrës". Faktet se dëshmitarët dhe infermierja e Qendrës së Parburgimit në Prizren kishin konstatuar se Astrit Dehari kishte puls dhe merre frymë para se të nxirrej nga dhoma u krye krimi, janë fakte të pakontestueshme, që përgënjeshtrojnë konstatimet e ekipit mjeko-ligjor të Kosovës rreth "ndaljes së menjëhershme të punës së zemrës".

2. Raporti i autopsisë i Astrit Deharit, i përpiluar nga Flamur Blakaj, Naim Haliti dhe Musa Gashi ka gjithsej 4 faqe e gjysmë tekst. Dhe në këtë "ekspertizë" prej katër faqesh e gjysmë, ekipi mjeko-ligjor zviceran gjeti 15 përkufizime të gabueshme, të cilat numërohen në 15 pika, të paraqitura në faqet 24-25 të raportit të datës 14 qershor 2019. Dhe bëhet fjalë vetëm për gabimet sa u përket lëndimeve që shihen nga ekzaminimi i jashtëm i trupit.

3. Si mund të pretendojë dikush, që mban titullin e mjekut-ligjor, se gjoja "kanë kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme", duke i cilësuar si "lëkurë e dëmtuar" katër pllakat e kuqërremta që shihen në pjesën e sipërme, të mesme dhe paramediane në anën e djathtë të ballit, në pjesën e mbuluar me flokë tek

Astrit Dehari? Ekipi mjeko-ligjor zviceran e hedh poshtë përkufizimin e ekipit mjekësor të Kosovës dhe këto lëndime i cilëson si pllaka pergamene, të cilat nuk janë shenja lëndimesh sipërfaqësore të lëkurës, por pamja që merr lëkura disa orë pas vdekjes në vendet ku janë shkaktuar lëndime të brendshme të indeve ose të organeve nga goditja me sende të forta.

4. Përveç Flamur Blakajt, Naim Halitit dhe Musa Gashit, cili ekspert mjeko-ligjor, që respekton Kodin Etik dhe Deontologjik të Mjekësisë, do t'i përkufizonte si "lëkurë e dëmtuar" pllakat pergamene në qafë dhe në parakrah të Astrit Deharit? Ekspertiza zvicerane e hedh poshtë përkufizimin e "ekspertëve" të lartpërmendur dhe vjen në konkluzionin se këto lëndime nuk janë lëndime sipërfaqësore, por pllaka pergamene që shprehin lëndime të brendshme të indeve ose të organeve, të cilat kanë qenë të shaktuara në vendet karakteristike për lëndime, që bëhen gjatë shtrëngimeve në qafë, siç janë kapjet e llojit "çelësi i krahut", ose me anë të formave të tjera të dhunës në qafë.

5. Me konstatimet e tyre, se gjoja këto lëndime në trupin e Astrit Deharit janë shkaktuar gjatë bartjes së trupit, gjatë përpjekjeve për ta kthyer në jetë ose gjatë turrjes muskulore të menjëhershme, Flamur Blakaj, Naim Haliti dhe Musa Gashi, që pretendojnë se paskëshin "kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme", kanë mundur të bindin prokurorët e llojit të Sylë Hoxhës, apo atyre që u ka

pëlqyer të dëgjojnë konstatime të formuluar në këtë mënyrë.

Nuk e di nëse janë skuqur nga inati kur kanë lexuar në raportin e ekspertizës zvicerane, se ekipi mjeko-ligjor i Qendrës Universitare Romande të Mjekësisë Ligjore në Lozanë shpreh qëndrimin e qartë, se "nuk ka mekanizëm bindës, që do të shpjegonte se si është e mundur që këto plaka pergamene të jenë shfaqur gjatë bartjes së trupit, gjatë përpjekjeve për ta kthyer në jetë ose gjatë turrjes muskulore të menjëhershme. Në fakt, nuk kemi të bëjmë me zona, ku bëhen kapjet gjatë bartjes (në rastin e transportit); nuk kemi të bëjmë me zona ku bëhen ndërhyrjet mjekësore në rastet urgjente (në rastin e përpjekjeve për ta kthyer në jetë) dhe as zona të skajshme të trupit, si: hunda, veshi, molla e Adamit, bërryli, të cilat do të ishin përplasur me pengesa në rastin e bartjes ose shtangimit muskuloz... Edhe pse teorikisht ato mund të shkaktoheshin nga bartja e trupit, nga veprimet për ta kthyer në jetë ose nga turrja muskulore, as pamjet e lëndimeve, as vendi ku gjenden këto lëndime nuk pasqyrojnë, në radhë të parë, lëndime të shaktuara nga njëri prej këtyre tre mekanizmave".

Pas gjithë kësaj, Flamur Blakaj, pa u skuqur fare, deklaroi në mënyrë të rrejshme, se gjoja mendimi i ekspertëve zviceranë dhe i Komisionit Mjekësor të Kosovës "përputhen në pjesën dërrmuese"!!!

6. A mund të cilësohet se e "kanë kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme", kur nga lëndimet që shihen nga ekzaminimi i jashtëm në nofullën e poshtme, "ekspertët" e Kosovës përmendin vetëm lëndimin që shihet në këndin e nofullës së poshtme, në anën e djathtë të saj, rreth 4 cm nga cepi i poshtëm i laprës së veshit dhe i japin diagnozën "skuqje (eritemë)". A thua janë skuqur nga inati ose nga turpi, kur kanë lexuar raportin e ekspertizës zvicerane, që hedh poshtë një diagnozë të tillë dhe argumentojnë se nuk kemi të bëjmë me "skuqje (eritemë)", por me mavijosje (ekimozë), që ndodhen në vendet karakteristike për lëndimet që janë shkaktuar gjatë kapjeve dhe lëndimeve në qafë. Përveç diagnozës së gabuar për këtë lëndim,

"ekspertët" e llojit të Flamur Blakajt, Naim Halitit dhe Musa Gashit, pa u skuqur fare, nuk e paskëshin parë "një ekimozë me ngjyrë të kuqe në kafe, në formë vezake, në skajin e pjesës së përparme të nofullës së poshtme"!!! Edhe pse nuk e kanë përmendur fare këtë lëndim, që shihej në skajin e pjesës së përparme të nofullës së poshtme të Astrit Deharit, ata pretendojnë të kenë "kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme"!!! Degradimi deri në këtë shkallë i një mjeku, e bën të skuqet çdo mjek që punon në përputhje me etikën dhe deontologjinë mjekësore.

7. Për ta "kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme", në "ekspertizën" e tyre prej 4 faqesh e gjysmë, Flamur Blakaj, Naim Haliti dhe Musa Gashi nuk gjetën vend të përmendin as lëndimin në pjesën e kokës, afër veshit të majtë, me ngjyrë të kuqërremtë, në formë lineare dhe horizontale. Ata nuk përmendin fare as çarjen sipërfaqësore në skajin anësor të pjesës së djathtë të gjuhës, që ndodhet përpara shqyerjes së përshkruar në raportin e autopsisë; ata nuk përmendin fare as njollat e kuqe në vjollcë në mukozën e rafemedianës të qiellzës së butë dhe të pjesës së pasme paramediane të djathtë të qiellzës së butë! Dhe pa u skuqur fare, pretendojnë se "kanë kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme".

8. Sa u përket plagëve sipërfaqësore, për të cilat ekspertët mjeko-ligjorë të Kosovës deklarojnë me "besueshmëri" se "janë dëmtime të vetëshaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë", ekspertët zviceranë pajtohen me "ekspertët" e Kosovës vetëm rreth mjetit me të cilin janë shkaktuar lëndimet: një mjet i mprehtë! Por kur duhet të përcaktohet se kush i shkaktoi këto lëndime, dallimet janë thelbësore. Ajo që për ekipin mjeko-ligjor është "e vetëshkaktuar", për ekspertët zviceranë është mjaft e dyshimtë, sepse "karakterit sipërfaqësor i këtyre plagëve nga njëra anë, dhe fakti se z. Astrit Dehari kishte njohuri mjekësore, nga ana tjetër, e bëjnë të vështirë të besohet që këto lëndime të jenë shkaktuar nga autori, me qëllim që të shkaktojë vetëvrasjen". Për lëndimet, që me lehtësi Flamur Blakaj, Naim Haliti dhe Musa Gashi deklarojnë se janë "të

vetëshkaktuara", për ekspertët zviceranë nuk përjashtohet ndërhyrja e faktorit të jashtëm në shkaktimin e lëndimeve të tilla. Përkundrazi, ata mbështetin domosdoshmërinë e ndriçimit të "hipotezës, nëse këto lëndime janë shkaktuar nga një person tjetër, me qëllim të maskimit të krimin". Nëse sillen fakte të pakontestueshme, që këto lëndime janë shkaktuar nga një person tjetër, atëherë hipoteza vërtetohet si e saktë. Në të kundërtën, ajo përjashtohet.

9. Përjashtimi i hipotezës për përfshirjen e personave të tjerë në këtë krim nuk mund të bëhet në mënyrën siç është vepruar, pa asnjë fakt, nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, apo vetëm për shkak se paska thënë Flamur Blakaj, anëtari i Komitetit Etik në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës dhe anëtar i bordeve etike të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës.

Një hipotezë e tillë duhet të përjashtohet, vetëm nëse me fakte të pakontestueshme dëshmohej që persona të tjerë nuk kanë qenë të përfshirë në procesin fatal. Deri te një përgjigje e saktë për këtë dilemë mund të vihet vetëm nëse bëhen analiza e hollësishme genetike të të gjitha sendeve që janë gjetur në dhomën e krimin, me kusht që dikush të mos i ketë shkatërruar gjurmët.

10. Nuk do të zgjatet në rendit të gjitha dallimet thelbësore që përmbajnë raportet e ekspertizës zvicerane, në krahasim me raportin e autopsisë të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës. I takon Flamur Blakajt apo kujt do qoftë tjetër që mendon si ai, të publikojë një shembull të vetëm, ku përputhen mendimet e dy ekipeve. As për ilaç nuk do të gjejnë një vlerësim të vetëm të ekspertizës zvicerane, që përputhet me atë të "ekspertëve" të Kosovës!

11. Sikur të kishin zbatuar Kodin e Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore, atë të miratuar nga Asociacioni Botëror i Mjekësisë, një raport të tillë të autopsisë nuk do ta kishin bërë "as në kushtet e kërcënimit dhe as që do të kishin lejuar keqpërdorimin e njohurive mjekësore".

12. Por, me sa shihet nga mënyra e veprimit të tyre në rastin e Astrit Dehari, studentit që ishte në prag të përfundimit të Fakultetit të Mjekësisë, në vend që të trajtohet me respektin që e meriton çdo qenie që ka vdekur në rrethana të dyshimta, Flamur Blakaj, Naim Haliti dhe Musa Gashi zbatuan parimin e shtrembëruar të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, që kërkon nga mjeku "të ruajë të gjitha fshehtësitë që i janë besuar edhe mbi vdekjen e pacientit".

Fatkeqësisht, për tri vite rresht, deri në ditën e publikimit të ekspertizës zvicerane, ata ruajtën të gjitha fshehtësitë mbi vdekjen e Astrit Deharit dhe kjo është e vetmja punë që komisioni i lartpërmendur mjekësor "ka kryer në mënyrën më të mirë të mundshme". Dhe, për habi, ata të cilët nuk zbatuan "Betimin e Hipokratit" gjatë autopsisë së Astrit Deharit, sapo u publikuan raportet e ekspertizës zvicerane, nxorën në shesh fytyrën e hipokritit.

13. Raporti i autopsisë i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, me numër reference IML: MA16-286, i datës 7 nëntor 2016, i kryer nga Flamur Blakaj, Naim Haliti dhe Musa Gashi, është raport i rrejshëm, që ka pasur për efekt negativ çorientimin e hulumtimeve për ndriçimin e rastit "Astrit Dehari". I takon prokurorisë së Kosovës, jo Sylë Hoxhës, që të vendosë rreth përgjegjësisë penale të komisionit mjekësor që përgatiti një raport të rrejshëm. Ndërkaq, Oda e Mjekëve të Kosovës duhet të marrë masa disiplinore kundër Flamur Blakajt, Naim Halitit dhe Musa Gashit, për arsye se raporti i autopsisë që kanë bërë, është keqpërdorim i njohurive mjekësore, që mundësoi fshehjen e krimin dhe, si i tillë, është një akt mjeko-ligjor që është në kundërshtim me nenin 73 të Kodit Etik dhe Deontologjik të Mjekësisë së Kosovës.

14. Kur bëhet fjalë për ngjashmëri të raporteve të autopsisë në rastin "Astrit Dehari", atëherë duhet të përmendim faktin, se raporti i Besim Ymaj dhe Besim Latifaj është i vetmi raport që ka ardhur në përfundime të njëjta me ato të ekspertizës zvicerane.

Sikur të ishin trajtuar me seriozitetin e duhur përfundimet e raportit të autopsisë që kanë kryer Besim Ymaj dhe Besim Latifaj, rasti "Astrit Dehari" do të ishte ndriçuar që para 3 vitesh. Fatkeqësisht, eksperti mjeko-ligjor nga Tirana dhe ai nga Londra jo vetëm që nuk u përfillën, jo vetëm që nuk u respektuan dhe jo vetëm nuk u morën në mbrojtje nga kolegët e tyre, por, përkundrazi, ndaj tyre u zbatuan presione të mëdha nga Ministria e Drejtësisë, nga prokuroria dhe nga policia e Kosovës.

15. Pas sqarimeve që kanë bërë ekspertët zviceranë, institucionet e Republikës së Kosovës, të përfshira në përndjekjen e Besim Ymajit dhe Besim Latifajt, duhet t'u kërkojnë falje publike dy ekspertëve mjeko-ligjorë. Ky veprim është minimumi që duhet të bëhet për të vënë në vend cenimin e integritetit profesional.

(VIJON: Përgjegjësia e institucioneve të Kosovës për fshehjen e vrasjes së Astrit Deharit)

Mjekët, objekt sulmi në vendin e tyre të punës



Prishtinë, 22 nëntor - Dhjetëra raste të sulmeve fizike ndaj mjekëve në vendin e tyre të punës janë raportuar gjatë vitit 2019. Rasti më i ri ishte raportuar ai i sulmit fizik ndaj një mjeku në Klinikën Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë derisa ai po ofronte trajtim shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës kishte reaguar duke shprehur shqetësim, indignatë dhe zhgënjim me këtë rast.

Kryetari i Odës së Mjekëve, Pleurat Sejdiu, thotë se në bazë të hulumtimeve të bëra në gjithë Kosovën, rezultoi se 78.8 për qind e mjekëve kanë deklaruar se kanë përjetuar një formë të dhunës, qoftë fizike apo verbale. Por, ajo që mbetet shqetësuese është se në 2.7 për qind të rasteve, dhuna ka vazhduar edhe jashtë institucioneve shëndetësore.

Një tjetër rast sulmi së voni kishte ndodhur edhe në Spitalin e Ferizajt, kur një mjek, po ashtu, ishte sulmuar derisa po kryente punën e tij.

Jeton Zeqiri, drejtor i spitalit të Ferizajt, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka treguar se si ka ndodhur ai rast në spitalin që ai udhëheq. "Ka qenë kujdestaria e datës 6 nëntor, në orën 12 e 40 pas mesnate, kur ka ardhur pacienti me shtypje të lartë të gjakut dhe gjakderdhje nga hunda. Mjeku kujdestar ka filluar trajtimin, fillimisht për ta ulur shtypjen e lartë të gjakut. Familjarët thonë që ta tamponojnë pacientin, e ky i fundit

iu shpjegon se duhet të presin deri në 10 minuta derisa të stabilizohet gjendja e pacientit dhe më pas ta bëjë tamponimin, përndryshe ka kundërindikacione. Por, pas kësaj familjarët fillojnë sulmin ndaj mjekut, pra bëhet fjalë për njërin djalë të pacientit, derisa edhe dy djemtë e tjerë që ishin duke pritur jashtë hyjnë në sallë dhe që të tre e sulmojnë mjekun. Më pas stafi mjekësor e qetëson situatën dhe e thërret policinë", ka sqaruar Zeqiri.

Lidhur me këtë rast, Prokuroria Themelore në Ferizaj kishte njoftuar se ishin ndaluar dy persona për shkak të dyshimit se të njëjtit kanë sulmuar personin zyrtar, përkatësisht mjekun S. F. në vendin e tij të punës, me ç'rast të njëjtit i kanë shkaktuar lëndime trupore.

Në anën tjetër, Oda e Mjekëve, përmes reagimit e cilëson shqetësues faktin se institucionet përgjegjëse, sidomos ato të ndjekjes penale, me pasivitetin e tyre, siç thuhet, "janë duke i stimuluar këto sulme që tanimë janë bërë fenomen ditor". "Prokuroria e shtetit dhe gjykatat duhet të vihen në veprim, sidomos në fazën e procedurës paraprake, në mënyrë që kryesve të këtyre veprave penale t'u caktohet masa e paraburgimit, duke marrë parasysh probabilitetin që vepra e tillë mund të jetë e përsëritur ndaj mjekut, i cili i është ekspozuar veprimit të tillë kriminal", theksohet në reagimin e Odës së Mjekëve.

Në Kosovë nuk ka ligj që i

mbron mjekët nga sulmet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Pleurat Sejdiu thotë se Oda e Mjekëve ka nisur një iniciativë për ta bërë ligjin që mbron mjekun në vendin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë, i cili aktualisht mungon. "Gjatë këtij viti, përpos sulmeve fizike, njëri është cilësuar si tentimvrasje, pasi mjeku është sulmuar me sëpatë. Ne si Odë e Mjekëve, përpos reagimeve, ofrojmë edhe mbështetjen ligjore nga zyra jonë dhe i procedojmë në instanca më të larta rastet e sulmeve", ka thënë Sejdiu. Ai shpreson që vitin e ardhshëm do të miratohet edhe ligji adekuat, duke marrë si shembull një ligj të ngjashëm nga Kroacia, me të cilin do të përcaktohet mbrojtja ligjore e mjekëve duke i përcaktuar edhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Faik Hoti, drejtor i Departamentit për Informim në Ministrinë e Shëndetësisë, thotë se një ligj i tillë është në fazën e hartimit dhe pritet të dorëzohet në Qeverinë e Kosovës (pas formimit të saj). "Koncept-dokumenti që pritet t'i paraprijë këtij ligji është në hartim e sipër. Pasi koncept-dokumenti të miratohet në Qeverinë e Kosovës, atëherë do të nisë edhe hartimi i ligjit i bazuar në opsionin e rekomanduar me këtë konceptdokument", ka bërë me dije Hoti. E, mantelbardhët për sulmet fizike ndaj tyre kanë shprehur pakënaqësinë shpeshherë edhe duke mbajtur protesta para objekteve ku punojnë.

Karrebauer: Jap dorëheqje nëse partia nuk më mbështet

BERLIN, 22 NËNTOR - Kryetarja e CDU-së, Annegret Kramp-Karrenbauer ofroi të heqë dorë nga posti i saj nëse nuk ka mbështetjen e partisë së vet. Kongresi i CDU-së këtë vit vjen në mesin e një luhateje të ndjeshme të përkrahjes për forcën politike po lufton për të ardhmen e saj pas Merkelit.

Kramp-Karrenbauer e pranoi se kristiandemokratët kanë pasur një vit të vështirë. Në fjalimin ku paraqiti vizionin e vet mbi të ardhmen e partisë së përballur veç rrudhjes së mbështetjes në radhët në sondazhe, edhe me

rezultate të dobëta ne zgjedhjet rajonale, pasuesja e Merkelit u tregua e hapur me pjesëmarrësit në konferencë.

"Nëse ju mendoni se Gjermania që unë dua nuk është ajo që dëshironi ju, atëherë them ta mbyllim me kaq. Këtu, tani, sot. Por nëse jeni të mendimit se duhet ta përshkojmë bashkë këtë rrugë, atëherë hajdeni të përveshim mëngët dhe të fillojmë", tha Karrebauer.

Ajo shënjestroi më tej rivalin Friedrich Merz dhe disa kritikë të tjerë, teksa tha se shënjestrimi i qeverisë së Merkelit, me

pretendimin se po bën çdo gjë gabim, nuk është aspak një strategji e mirë fushate. Kristiandemokratët gjermanë e gjejnë veten në udhëkryq, ndërsa janë duke u përgatitur për një të ardhme pa Merkelin, e cila nuk do të kandidojë për rizgjedhje kur t'i përfundojë mandati në vitin 2021.

Kryetarja aktuale e partisë, Kramp-Karrenbauer është parë si pasardhëse e mundshme e saj si kancelare, por anketimet e fundit kanë treguar një turrje të ndjeshme të mbështetjes për të edhe brenda vetë partisë së saj.



Trumpi dëshiron gjykim nga ana e Senatit

Aktualisht Komiteti për Inteligjencë i Dhomës së Përfaqësuesve është duke zhvilluar seanca publike me dëshmitarë në kuadër të procesit të nisur për shkarkimin e presidentit Donald Trump, i cili dëshiron që gjykimi të procedohet në Senatin e ShBA-së për shkak se aty do të kishte një proces të duhur



WASHINGTON, 22 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dëshiron që gjykimi për shkarkimin e tij të procedohet në Senatin e ShBA-së për shkak se aty do të kishte një proces të duhur, tha një zëdhënës i Shtëpisë së Bardhë. "Trumpi pret që kandidati demokrat për president, Joe Biden të jetë në mesin e dëshmitarëve", tha zëdhënësi, Hogan Gidley, ka njoftuar rre. "Ne presim që përfundimisht të dëgjojmë nga dëshmitarët që potencialisht kanë qenë të përfshirë në korrupsion siç janë: Adam Schiff, Joe Biden, Hunter Biden dhe i ashtuquajtur "informatori", dhe Gidley.

Aktualisht Komiteti për Inteligjencë i Dhomës së Përfaqësuesve është duke zhvilluar seanca publike me dëshmitarë në kuadër të procesit të nisur për shkarkimin e presidentit, Donald Trump. Në rast se Dhoma e Përfaqësuesve, e kontrolluar nga demokratët, e voton fajësinë e Trumpit, atëherë në bazë të

Kushtetutës, çështja i kalon Senatin, ku shumicën e kanë republikanët.

Senati zhvillon seancë gjyqësore dhe merr vendimin përfundimtar nëse presidenti amerikan duhet shkarkuar nga detyra.

Hetimet ndaj presidentit, Donald Trump, nisën pasi një informator i paidentifikuar dërgoi një ankesë në lidhje me një telefonatë të zhvilluar në muajin korrik ndërmjet presidentit Trump dhe homologut të tij Ukrainas, Volodymyr Zelenskiyt.

Sipas këtij informatori, Trumpi gjatë telefonatës, i kërkoi Zeleneskiyt që të hetojë për korrupsion rivalin e tij politik, ish-nënpresidentin, Joe Biden, dhe djalin e tij, Hunter Biden. Joe Biden po synon nominimin e demokratëve për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020.

Përveç kërkesës për hetim, sipas ankesës së informatorit, Trumpi kishte kushtëzuar edhe një ndihmë ushtarake për Ukrainën.

Demokratët reagojnë menjëherë duke thënë se kjo përbën

shkelje, pasi presidenti ka kërkuar ndihmën e një vend të huaj në mënyrë që t'i fitojë zgjedhjet në ShBA.

I gjithë "presioni" ndaj Ukrainës thuhet se është bërë përmes Rudy Giuliani, avokat personal i presidentit Donald Trump.

Në Komitetin për Inteligjencë të Dhomës së Përfaqësuesve tashmë kanë paraqitur dëshminë një numër zyrtarësh të lartë amerikanë, të cilët kanë pasur njohuri, apo kanë qenë të angazhuar në raportet e ShBA-së me Ukrainën.

Dëshmia më e rëndësishme është vlerësuar të jetë ajo e

Gordon Sondland, ambasador amerikan në Bashkimin Evropian.

Sondland ka thënë se ka ndjekur "urdhurat e presidentit" ku është marrë me Ukrainën dhe se ka punuar me avokatin personal të Trumpit, Rudy Giuliani, "për të thyer bllokadën" dhe për të siguruar përsëri ndihmën në vlerë të qindra miliona dollarëve për Kiev.

"Giuliani ka kërkuar që Ukraina të bëjë një deklaratë publike për nisje të hetimeve. Ai ka folur për teoritë diskredituese rreth përpjekjeve ukrainase dhe jo atyre ruse për ndërhyrje në

zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, si dhe për një kompani të gazit në Ukrainë që është e lidhur me djalin e Bidenit", tha Sondland.

Por, në dëshminë e 21 nëntorit para Komitetit për Inteligjencë, ish-zyrtarja e lartë e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Fiona Hill tha se Trumpi shpërfilli këshilltarët e vjetër dhe nxori një teori të rreme se Ukraina ishte përzier në zgjedhjet e vitit 2016.

Fiona Hill tha se presidenti kishte dëgjuar pikëpamjet e avokatit të tij personal, Rudy Giuliani.

Hill i quajti pretendimet për Ukrainën një "narracion imagjinar".

Kremlini i bindur që "spiunimi" nuk do ta dëmtojë partneritetin me Serbinë

MOSKË, 22 NËNTOR - Kremlini shprehu besimin se vizita e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, muajin e ardhshëm në Moskë, "do të demonstrojë edhe një herë frymën e partneritetit" midis dy vendeve.

Deklarata vjen pasi Beogradi tha se ka zbuluar një skandal spiunimi, ku përfshihen agjentët rusë. "Besojmë se vizita është shumë e rëndësishme dhe ne e kuptojmë se ekzistojnë disa palë që duan ta dëmtojnë atë", tha

Dmitry Peskov, zëdhënës i presidentit të Rusisë, Vladimir Putin.

"Jemi të bindur se palët e tilla do të dështojnë", shtoi ai.

Serbia synon të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, por, në të njëjtën kohë, është aleate e ngushtë e Moskës.

Vuçiqi, të enjten, konfirmoi se një zyrtar i inteligjencës ruse, gjatë një takimi në dhjetor të vitit të kaluar, i ka dhënë rryshfet një koloneli të pensionuar serb.

Vuçiq i bëri deklaratat pas publikimit të një videoje në

"YouTube", në lidhje me këtë takim.

Presidenti serb, po ashtu, tha se shërbimet e sigurisë në Serbi kanë gjetur dëshmi edhe për dhjetë kontakte midis agjentëve rusë dhe zyrtarëve serbë.

Megjithatë, ai shtoi se operacioni i spiunimit nuk do t'i ndikojë marrëdhëniet "shumë miqësore" të Serbisë me Rusinë.

Ministria e Jashtme e Rusisë e cilësoi videon në "YouTube" si "provokim" përpara takimeve të rëndësishme të nivelit të lartë.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

2 000 dronë ngritin lart një kamion 40 tonë

Me siguri se raste të tilla nuk keni hasur akoma. Për dikë edhe mund të duket e pabesueshme, por pamjet tregojnë se rreth 2 000 dronë e kanë ngritur në ajër një kamion të madh të peshës 40 tonë të markës "Scania". Video e cila po qarkullon në rrjetet sociale ka marrë më shumë se dy milionë shikime në "Twitter". Kjo video ka ngjallur edhe reagime të shumta.




FOTO E DITES



Disa të rinj mbajnë pankarta para një mase të shenjtë të udhëhequr nga Papa Françesku në Stadiumin Kombëtar në Bangkok të Tajlandës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Krijesa të çuditshme filmohen duke bërë ritual në ujë

Një grup turistësh në Tajlandë janë përballur me një situatë aspak të zakonshme. Ata kanë filmuar disa krijesa të çuditshme teksa shihen duke bërë disa rituale mjaft të habitshme. Videoja është filmuar në Raily Bay në Tajlandë, ndërsa dëshmitarët shprehen se ndihen të tronditur nga ajo se çfarë panë. Pamjet janë regjistruar nga



Jamai Kawai, ndërsa askush nuk e shpjegon dot llojin e krijesave.

BARSOLETA E DITËS



I dashuri: Zemër, a je nervoz?
E dashura: Jo, nuk jam.
I dashuri: Ani hajde të përqafoj.
E dashura: Shko përqafoje atë që ia ke bërë like në "Facebook".



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Në dashuri do t'ju hapen

porta të reja që nuk i kishit imagjinuar. Një takim i rastësishëm do të jetë mjaft interesant.



DEMI
I gjithë fokusi juaj sot është përqendruar

te financat dhe te karriera. Jeni në zhvillime shumë të rëndësishme për të ardhmen në këto fusha.



BINJAKËT
Një ditë e qetë dhe me të gjitha

gjërat mirë të organizuara. Do të jeni mjaft të dashur me personat që keni afër vetes.



GAFORRJA
Po e nisni këtë ditë me këmbën e

gabuar dhe kjo gjë do të reflektojë në çdo vendim tuajin në orët në vazhdim.



LUANI
Sot jeni shenja me më fat e

horoskopit. Çdo gjë është siç dëshironi, madje disa situata do të dalin më mirë sesa që e prisnit.



VIRGJËRËSHA
Jeni përqendruar në investime

afatgjata, por dita e sotme do t'ju kushtëzojë të zgjidhni sa më shpejt disa probleme financash.



PESHORJA
Sot jeni ju protagonistët e

ditës dhe kjo gjë do t'ju pëlqejë. Në çdo aspekt do të kërkoni më të mirën e gjërave.



AKREPI
Duhet të përshatani me ndryshimet

sot. Do të ndodhin shumë shpejt dhe ju do të jeni të luhatur përgjatë gjithë ditës.



SHIGJETARI
Sot jeni përqendruar në objektivat

që janë me të shpejta për t'i arritur. Persona afër jush duan të përfitojnë në atë që mund të arrini.



BRICJAPI
Sot nuk po organizoheni dot siç duhet.

Fillimi i javës do t'ju gjejë kaotik dhe në rrëmujë e sipër.



UJORI
Do të jeni tip flirtues gjatë gjithë

ditës. Keni mbi vete sharmin e personave që dinë çdo gjë dhe njohin këdo.



PESHQIT
Sot parashikohen debate me

partnerin. Në shumë gjëra nuk do ta ndani të njëjtin mendim.

Angelina Pivarnick martohet me Chris Larangeira



Angelina Pivarnick është një grua e martuar tani. Ylli i "Jersey Shore" u kurorëzua me Chris Larangeira të mërkurën pranë familjarëve të tyre në New Jersey. "Çifti është


i emocionuar për këtë ditë të veçantë", ka treguar një burim për "Page Six". Pivarnick, gjithashtu 33 vjeçe, ka veshur një fustan "Castle Couture", sipas "Entertainment Tonight".

Pas Dua Lipës edhe Tyga do të performojë për herë të parë në Mumbai



Reperi amerikan Tyga do të performojë për herë të parë në Mumbai të Indisë në kuadër të festivalit Sunburn. Tyga do të performojë para adhuruesve indianë më 29 nëntor. "Kam pasur një përvojë të shkëlqyeshme në New Delhi vitin e kaluar, por unë gjithmonë kam

dashur të udhëtoj në Mumbai. Kam dëgjuar industrinë e muzikës hip hop. Është një nga të cilat duhet të kujdesem. Jam vërtet e entuziazmuar të marr pjesë në koncertin e arenës të Sunburn", ka thënë Tyga. Në këtë festival kanë performuar edhe Katy Perry dhe Dua Lipa.



Edhe Rita Ora preket nga gripi

Këngëtarja e njohur kosovare Rita Ora është bërë pjesë e filmit "Twist" ku ka njërin nga rolet kryesore. Ora ka thënë se është e sëmurë dhe se ka marrë ndihmë mjekësore, për këtë ajo ka ndërprerë një pjesë xhirimeve të filmit. "Jo grip, nuk do të më mar-

rësh! Ndërprerjet e xhirimit të filmit në kohën e drekës/pushimi i katërt. Unë jam në rregull, vetëm dua që të siguroheni që unë do ta përfundoj këtë gjë para ditëlindjes time të martën! Dhe t'jua sjell këtë film të mahnitshëm! #Twist", ka shkruar Ora në "InstaStory".

Pete Davidson thotë se e trajton çdo të dashur si princeshë

Nuk është vetëm energjia e Pete Davidsonit që ka mbajtur të lumtura të dashurat e tij. "Gjuha ime e dashurisë kur jam në një lidhje është që të trajtoj atë si një princeshë", ka pohuar ylli i "Saturday Night Live" për "Paper". "Unë përpiqem të shkoj sa më lart dhe më gjerë që është e mundur, sepse kjo është ajo që



duhet të bësh. Nëse jeni në një marrëdhënie me dikë, thjesht duhet ta bëni atë person të ndihet sa më i veçantë", ka thënë ai.

Gjuha shqipe e klasës së dhjetë, me plot lëshime

(Vështrim për librin e klasës së dhjetë - "Gjuha shqipe")

Shkruan: Gani K. RUDAJ

Teksti "Gjuha shqipe për klasën e dhjetë", i autorëve Idriz Mejtani dhe Mimoza Gjokutaj, me recensentë Hava Shala-Qyllalla, Xhabir Hajredinaj dhe Lumturie Lila, është hartuar mbi bazën e programit të lëndës së gjuhës shqipe të shkollave të mesme.

Ky tekst është paraparë të jetë një armë aktive për nxitje të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga mësimdhënësit, si dhe të ketë një aktivitet më interesant te nxënësit në orën mësimore në lëndën e gjuhës shqipe. Mirëpo, duke e lexuar këtë libër kam vërejtur disa zbrazëti në këtë tekst. Autorët e librit thonë se gjuha shqipe është varianti më i përpunuar për t'u përdorur në komunikim zyrtar, në administratë, në arsim, shkencë, në praktikën shkri-more dhe botuese në të gjitha mjediset shqiptare.

Është thënë shumë bukur.

Në radhë të parë ky libër nuk guxon të ketë asnjë gabim gjuhësor, natyrisht se ky parim vlen edhe për libra të tjerë. Për shmangien e gabimeve gjuhësore gjithmonë na ndihmon Fjalori Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe.

Po filloj me analizën e librit nga këndvështrimi im.

Në faqe 14 në këtë libër është mësimi me titull: Kthimi i tekstit të vjetër shqip në shqipin standarde dhe si nëntitull: Ndryshimet historike të tingujve të shqipes.

Në këtë mësim janë shkruar teksti i Gjon Buzukut Kënga e këngëve II, teksti i Lekë Matrëngës Këngë e përshpirtëshme si dhe vjersha e Pjetër Budit Adami dhe Eva. Në të tria këto tekste më tepër është shkruar për kuptimin e tyre përmbajtësor, d.m.th. analiza e tyre artistike dhe kjo punë është bërë mjaft mirë. Ajo që këtu nuk po shoh është se nuk janë përmendur ndryshimet historike të tingujve të shqipes. Nuk ka shpjegime për rotacizmin, palatalizimin, metafoninë e apofoninë.

Autorët është dashur të japin shpjegime për këto dukuri fonetike me shembuj konkretë. Në faqe numër 18 kemi mësimin me titull: Rikapitullimi i mbiemrit, punë praktike, tekst kreativ. Në këtë mësim është dashur të jepet një shpjegim më i plotë për mbiemrin. Psh. aty nuk është cekur se mbiemrat kanë kategorinë e gjinisë, kanë

numër e rasë. Nuk është cekur se mbiemri është dy llojesh: i nyjshëm dhe i panyjshëm, si dhe nuk u përmend se mbiemri ka tri shkallë: pohoren, krahasoren dhe sipëroren.

Pastaj është dashur të jepet një pasqyrë e lakimit të mbiemrave. Nuk e shoh të arsyeshme që mbiemri të mësohet para emrit. Mësimi në faqe 21 mban titullin: Rishikimi i modeleve të sentencave bazike dhe hyrje në modelet e sentencave të reja dhe si nëntitull: Ç' është sintaksa? Pse e studiojmë atë?

Në këtë njësi mësimore nxënësi duhet të marrë njohuri nga sintaksa.

Një gjë nuk mund ta kuptoj se si mund t' i mësojmë nxënësit për sintaksën kur ata nuk kanë njohuri të plota për fonetikën dhe morfologjinë. Gjuhëtarët e dinë se Sintaksa është logjika e gjuhës dhe ajo është e thellë sa një oqean. Njohuritë për sintaksën arrihen vetëm atëherë kur nxënësi ka njohuri të mjaftueshme për fonetikën dhe morfologjinë.

Sa i përket mësimin me titull Fjalë, autorët janë përpjekur ta shpjegojnë mirë, por nuk e kanë cekur që kemi fjali pohore dhe mohore si dhe për të dhënë shembuj për to. Mësimi në faqe 23 me titull: Ushtrime drejtshkrimi, efektet letrare. Ky mësim është për t'u lavdëruar.

Është mësim që e plotëson mësimin e fjalisë. Pyetjet dhe ushtrimet që janë dhënë në këtë mësim janë të qëlluara. Mësimi në faqe 34 mban titullin: Analiza e teksteve letrare. Në këtë mësim jepen shpjegime për analizën filologjike, analizën e strukturës dhe analizën e kompozicionit të një veprë letrare. Më duket se autorët kanë bërë punë të shkëlqyeshme. Mësimi në fjalë është i kapshëm për moshën e nxënësve. Unë mendoj se ky mësim është si një pasqyrë ku nxënësi vetëm duhet të shikohet në të.

Edhe mësimi Shkrimi i një rrëfimi që është në faqe 42 është i kapshëm për nxënësit. Autorët kanë bërë punë të mirë.

Në faqe 45 kemi mësimin Rishikimi i pjesëve të ligjëratës. Këtu autorët kanë shkruar për pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës.

Fjalët e ndryshueshme - Këtu autorët i përmendin pjesët e ligjëratës, si: emri, folja, mbiemri, përemri dhe numërori. Në shpjegimin e emrit ata thonë se kemi emra

frymorë, sende konkrete, dukuri të natyrës, emra cilësorë, veprime ose gjendje, nocione abstrakte (e mira, e keqja), emra të përgjithshëm e abstraktë, emra të përveçëm, emrat përmbledhës, emrat e lëndës.

Të gjitha këto u shpjeguan mjaft mirë, por unë mendoj se është dashur të jepej një pasqyrë e lakimit të emrit në numrin njëjës dhe shumës në të dy trajta dhe për të dy gjinitë.

Pastaj nuk u përmend se gjuha jonë ka edhe emra ambigjenë. Pastaj nuk u përmend që kemi emra, të cilët përdoren vetëm në njëjës dhe emra që janë vetëm në shumës.

Tek emrat me nocione abstrakte, si E MIRA, E KEQJA etj. nuk thuhet se këta janë mbiemra të emëruar që kanë hyrë në klasën e emrave.

Folja - Këtu autorët janë marrë me shpjegimin e foljes, por me mangësi. Foljes ia kanë kushtuar vetëm 25 rreshta!!!

Folja është hapësja e gjuhës. Për këtë pjesë të ligjëratës duhet të shkruhet një kapitull i tërë. Këtu nuk shpjegohet se ne i kemi tri zgjedhime të foljeve plus foljet e parregullta me nënndarjen e tyre. Nuk shpjegohet se si zgjedhohen ato në kohë dhe mënyra dhe në dy diateza.

Këtu shoh vetëm foljen Rrinin, por tjetër shpjegim nuk ka. Foljet 'jam' dhe 'kam' as që përmenden gjithashtu edhe foljet gjysmëndihmëse 'mund e duhet'. Shpjegime të pamjaftueshme jepen për foljet kalimtare dhe jokalimtare.

Mbiemri - Gjithashtu kemi mangësi në të shpjeguarit e kësaj pjese të ligjëratës. Këtu thuhet se mbiemri ka gjini, numër dhe rasë. Këtu duhet të

them se mbiemri ka tri shkallë: pohoren, krahasoren dhe sipëroren. Edhe këtu mungon tabela e lakimit të mbiemrave në të dy numra dhe në të dy gjini. Gjinia e mbiemrit përcaktohet nga gjinia e emrit.

Përemri - Këtu autorët bëjnë ndarjen e përemrave. Në të gjitha pjesët e ligjëratës autorët fillojnë me vargun: "është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës", por asnjëherë nuk e shpjegojnë se PSE është e ndryshueshme.

Te përemrat vetorë autorët vetëm i përmendin se cilët janë ata. Nuk ka tabelë ku tregohet se si lakohen ato.

Asnjëherë autorët nuk përmendin se përemrat vetorë në rasën dhanore dhe kallëzore kanë edhe trajtat e shkurtra të tyre.

Te përemrat dëftorë, autorët vetëm i numërojnë ato. Nuk ka tabelë të lakimit të tyre. Te përemrat pronorë jepet një pasqyrë e lakimit të tyre sa për sy e faqe. Autorët te përemrat pyetës na shpjegojnë se për çka na nevojiten, por nuk ka lakime të tyre. Për përemrat e pacaktuar ka shpjegime të cekëta. Nuk ka tabelë të lakimit të tyre. Te shpjegimi për përemrat lidhorë më vjen çudi se këtu është përmendur vetëm përemri QË.

Shqipja ka edhe përemra të tjerë lidhorë, si: i cili, e cila si edhe në numrin shumës: të cilët, të cilat. Duhet të cek këtu se nuk jepet shpjegim për përemrin QË kur është lidhëz dhe kur është përemër. Për shpjegimin e numërorëve është paksa më i mirë. Prej të gjitha pjesëve të ndryshueshme autorët nuk e përmendën nyjën.

Fjalët e pandryshueshme - Për

ndajfoljen u shkrua Fati krejt, por nuk u cek që edhe ndajfoljet sikur mbiemrat kanë shkallët e tyre.

Për PARAFJALËT, LIDHËZAT dhe PASTHIRRMAT, nxënësi mund të marrë njohuri të mira. Sipas asaj që kam lexuar në këtë libër mund te them se mësimet prej faqes 54 e deri në fund që është shkrimi i autobiografisë, nuk kam ndonjë vërejtje.

Gabimet gjuhësore në këtë libër

- Gabimet gjuhësore në këtë libër janë: në faqe numër 5 në hyrje është përdorur gabimisht përcjellorja 'duke patur' trajta e drejtë është 'duke pasur'.

2. Në faqe numër 17 është shkruar: Të tre tekstet... trajta normative është: të tri tekste. Po në këtë faqe është përdorur gabimisht parafjala e rasës emërore 'tek' te fjalia tek doktrina..., këtu duhet përdorur parafjala 'te'.

3. Në faqe 26 është përdorur fjalia 'Pikëçuditëse', ndërsa duhet të jetë 'Pikëçuditje'.

4. Vlen ta përmend se 52 herë është përdorur gabimisht fjalia: Për klasën 10-të. Këtu duhet të mos shkruhet kjo 'TË', sepse nëse numrin e shkruajmë me shkronja si p.sh PËR KLASËN E DHJETË - TË, mua po me duket qesharake. Kjo 'TË' e ka vendin te numërorët 2,3 e 5. P.sh. klasa e 2-të, e kështu më tej.

Dhe për fund: në fund të librit në faqe 108 e 109 është shkruar data 16.07.1980.

Data në gjuhën shqipe shkruhet pa Zero.

Nëse largohen këto gabime dhe plotësohet libri nga këto vërejtje, por edhe nga të tjerat, ky libër mund të përdoret për klasën e dhjetë.

Ndryshe jo!



'Libri i luftës' i Nuhi Bytyçit çmohet vepër me vlera historike edhe në Tetovë


Afaristi i njohur i përmasave ndërkombëtare, Lazim Destani, ka shprehur gatishmërinë që të kontribuojë për përkthimin dhe botimin e "Librit të luftës" edhe në gjuhën angleze

TETOVË, 22 NËNTOR - Në kuadër të manifestimeve tradicionale "Tetova feston nëntorin 2019", në Tetovë u bë promovimi i "Librit të luftës" i gazetarit shqiptar Nuhi Bytyçi. Promovimi filloi me shfaqjen e xhirimeve dokumentare nga ngjarjet e shumta historike nga të gjitha trojet etnike shqiptare të periudhës më se 40-vjeçare, nga të cilat ka raportuar dhe përgatitur edhe dokumentarë të ndryshëm e që histori të tyre janë përfshirë edhe në këtë libër.

Duke e hapur këtë ngjarje të rëndësishme, gazetari tetovar Seladin Xhezairi përkujtoi: "Kolegu im Nuhi Bytyçi qysh nga periudha e punës në Radiotelevizionin e Prishtinës, me guximin intelektual ishte pjesë e rezistencës kombëtare edhe në kohën e tubimeve gjithëpopullore kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës, edhe në grevën e minoriteteve të 'Trepçës' në vitin 1989. Ai ishte në këtë rol edhe më 2 korrik 1990, në ditën e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese për Kosovën Republikë. Në epokën e rezistencës së viteve nëntëdhjeta, gazetari Nuhi Bytyçi me profesionalizëm kreu detyrën e gazetarit, duke afirmuar organizimin e sistemit të pavarur të Republikës së Kosovës në fushën e arsimit, të shëndetësisë dhe të financimit të institucioneve të Republikës së Kosovës".

Xhezairi ka shtuar se gazetari shumëvjeçar, publicisti i njohur shqiptar, Nuhi Bytyçi ka luajtur rolin jo vetëm të gazetarit e të intelektualit, por edhe të protagonistit, rolin e krijuesit të klimës politike për rezistencë kombëtare kundër okupimit serb. Xhezairi ka theksuar se me fillimin e hovshëm të luftës çlirimtare në vitin 1998, Nuhi

Bytyçi bëhet pjesë e kësaj lufte, duke raportuar dhe duke realizuar emisione televizive për rezistencën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që nga Drenica, Dukagjini, deri te Llapusha, Anadriina, Llapi, Shala dhe Neredimja. "Libri i luftës është libër i luftës për thyerjen e censurës në Televizionin e Prishtinës, i luftës për të vërtetën e Kosovës, i luftës për mposhtjen e frikës dhe dinamizimin e lëvizjes për liri. Është libër i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i Kosovës së lirë, për kontributin e diasporës shqiptare në të gjitha proceset e popullit shqiptar para, gjatë dhe pas luftës. Është libër i luftës së shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni, luftës për mbrojtjen e UÇK-së në Tribunalin e Hagës, për rrugëtimin për pavarësi dhe shtetndërtim", ka thënë Xhezairi. Ndërkaq, duke folur për veprimtarinë e Nuhi Bytyçit si gazetari profesionist, ish-kolegu i tij i studimeve, ish-drejtori i Agjencisë së Informacionit të Maqedonisë, profesori universitar Vebi Bexheti, ka theksuar se "Libri i luftës" i Nuhi Bytyçit përmes rrëfimeve origjinale dokumentare nga ngjarjet të cilat i ka përjetuar vetë dhe ka raportuar nga to, na i përkujton që mos t'i harrojmë. "Ky libër ka vlera të posaçme për historinë dhe publicistikën shqiptare dhe do të jetë dëshmi e rrugëtimin të gjatë e të vështirë të popullit shqiptar", është shprehur ai. Bexheti ka përkujtuar kontributin dhe përkushtimin profesional të Nuhi Bytyçit, të kolegut të tij Qani Mehemit dhe kolegëve të tjerë të tyre nga Radiotelevizioni i Kosovës për ta informuar opinionin lidhur me zhvillimet gjatë periudhës së luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare



në Maqedoni në vitin 2001.

Në emër të organizatorit të promovimit, Ahmed Qazimi nga sektori i arsimit i Tetovës, ka theksuar: "Për ne është nder dhe privilegj që në kuadër të manifestimit 'Tetova feston nëntorin' ta prezantojmë këtë libër të rëndësishëm që i jep zë origjinal luftës çlirimtare të Kosovës në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni dhe na mundëson që të njihemi për së afërmi me këtë histori të lavdishme nga pena e një gazetari, i cili me përkushtim shpalos ngjarjet të cilat i ka përjetuar gjithandë në terren dhe në fushë beteja".

Ndërkaq, sponsori kryesor i "Librit të luftës", afaristi i suksesshëm edhe në nivel ndërkombëtar, Lazim Destani, ka thënë se duke e njohur mirë veprimtarinë e gazetarit të dëshmuar profesionist, Nuhi Bytyçi qysh në vitet '90, ka vlerësuar se duhet ta mbështesë botimin e librit të tij, i cili ka përmbajtje dhe vlera tejet të çmueshme për historinë më të re kombëtare. Destani ka shprehur gatishmërinë që të kontribuojë edhe për përkthimin dhe botimin e "Librit të luftës" edhe në gjuhën angleze.

Duke falënderuar për vlerësimet e Seladin Xhezairit, Vebi Bexhetit, Ahmed Qazimit dhe të Lazim Destanit lidhur me "Librin e luftës", si dhe organizatorin e

promovimit, Jeton Pustinën, autori i librit, Nuhi Bytyçi, ka thënë se mesazhi i tij për opinionin, të cilin është munduar që ta thotë edhe në "Librin e luftës", është i qartë: e tërë jeta e njeriut është luftë, ndërsa e tërë veprimtaria e një gazetari profesionist është lufta për të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. "Unë personalisht, nuk kam kursyer asgjë vetëm që opinionit t'ia paraqes të vërtetën për njeriun e tokës sonë, për ngjarjet, proceset dhe zhvillimet që lidhen me aspiratat e popullit shqiptar në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoninë Veriore, në Kosovën lindore, në Mal të Zi, në diasporën tonë për liri, pavarësi, prosperitet dhe bashkim kombëtar", ka thënë ai.

Bytyçi ka përkujtuar se "atëherë kur gazetari rrezikon çdo gjë, madje edhe jetën për t'u shërbyer interesave të publikut, popullit, e kurrsesi interesave të politikës ditore dhe interesave të biznesit, arrin ta kryejë me sukses misionin e vet profesional, kombëtar dhe human".

"Libri i luftës", shtoi Nuhi Bytyçi, ka plot shembuj konkretë se si një gazetar, edhe në rrethana okupimi, në rrethana të terrorit shtetëror policor e ushtarak, edhe atëherë kur në tunelin e gjatë nuk shihej asnjë dritë, me përkushtimin, vendosmërinë dhe sakrificën e madhe, me informatat e vërteta dhe inkurajuese, mobilizoi një popull të tërë dhe botën demokratike për të marrë energji dhe për të vepruar e luftuar për realizimin e synimeve të veta drejt lirisë, prosperitetit dhe civilizimit evropëndimor. Bytyçi ka theksuar se shqiptarët e Maqedonisë veriore në të gjitha periudhat dhe proceset politike e të tjera kanë qenë përherë pranë vëllezërve e motrave të tyre në Kosovë dhe kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, sidomos gjatë luftës për liri dhe pavarësinë e Kosovës, si dhe për ndërtimin e shtetit demokratik të Kosovës. "Në librin tim jam përpjekur që të fokusohem në mënyrë të veçantë edhe në zhvillimet në Maqedoninë Veriore nga vitet '90, kur u paraqitën në skenë

edhe intelektualët dhe forcat politike shqiptare, në krye me Arben Xhaferin, Nevat Halilin, Iliaz Halimin e të tjerë, por edhe zhvillimet dramatike gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare udhëhequr nga komandanti i përgjithshëm Ali Ahmeti dhe bashkëpunëtorët e tij", ka thënë autori i librit.

Nuhi Bytyçi para pjesëmarrësve të promovimit të librit autobiografik përkujtoi edhe këto momente: "Ishe kënaqësi për mua dhe kolegun tim Qani Mehmedi që përmes kronikave dhe emisioneve tona speciale ta informojmë opinionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar lidhur me zhvillimet gjatë periudhës së luftës në Malësinë e Tetovës, në Shpikovicë, në Radushën kryengritëse, në fshatrat e Likovës, në Orizaren e Ismet Jasharit-Kumanovës, në Sllupçan, Hotël, në Opajë, në Mateq, ku ranë heroikisht edhe trimat e Malishevës, Labinot Krasniqi, Elmi Hoti dhe Visar Krasniqi, në Vaksincë, ku ra heroikisht Fadil Nimani-Tigri e në malësinë e Gostivarit, në vendin ku ra edhe heroi i kombit Tahir Sinani, Hyrë Emini, Naser Ademi, Brahim Ademi e Hisë Fazliu".

Me këtë rast Bytyçi ka falënderuar ish-drejtorin e Agjencisë së Informacionit të Maqedonisë, Vebi Bexhetin, i cili e kishte mbështetur atë, duke siguruar edhe akreditim zyrtar për ekipin e RTK-së që mos të ketë pengesa nga policia maqedonase dhe t'i pasqyrojë zhvillimet e periudhës së luftës çlirimtare në Maqedoni. Ndërkaq, për kontributin e tyre në botimin e "Librit të luftës" autori ka falënderuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit të Republikës së Kosovës dhe mikun e tij, afaristin e përmasave botërore, Lazim Destanin, pastaj botuesin Berat Dakaj, recensentin e librit, Bajram Kosumi, redaktorët Haqif Mulliqi e Muhamet Mavraj, të birin e vet Arianitin për sugjerimet përmbajtjesore, autorin e fotografisë së ballinës Avni Selmani, dazajnerin Luan Tashi dhe shtypshkronjën "Iliri" në Prishtinë.

Nuhi Bytyçi shfrytëzoi këtë rast që ta falënderoj në mënyrë të veçantë familjen e heroit të Kosovës, Ismet Jashari-komandant "Kumanovës", të cilin e kishte takuar dhe intervistuar në malet e Kleçkës, familjen e mikut të tij Ramadan Sinanit, si dhe familjen e Enver dhe Naim Xhaferit në Bogovinë të Tetovës, ku ai dhe familja e tij kishin gjetur strehim dhe mbështetje të madhe në kohë të vështira, në fillim të prillit të vitit 1999. Nuhi Bytyçi ka paralajmëruar se gjatë dhjetorit të këtij viti "Librin e luftës" do ta promovojë edhe në kryeqytetin e Shqipërisë, në Tiranë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Drita dhe Llapi kërkojnë fitore në derbi

Drita dhe Llapi kanë synim të shënojnë fitore në derbin që zhvillohet në Gjilan. "Synimet tona nuk ndryshojnë në asnjë ndeshje, përfshirë edhe ndaj skuadrës së Llapit. Presim fitore në mënyrë që ta vazhdojmë garën për pozitën e parë në tabelë. Kundërshtari është mjaft i fortë dhe ka individë mjaft cilësorë, por jemi të bindur në sukses. Mungesa e vetme është e Xhevdet Shabanit, por kemi lojtarë të mirë dhe besojmë se nuk do të vërehet mungesa e tij", ka thënë Fidan Gërbeshi



IPKO Superliga - Java e 16

Ballkani - Gjilani 2-1

Të shtunën takohen:
13:00 Drita - Llapi
13:00 Flamurtari - Feronikeli
13:00 Drenica - Vushtrria
14:00 Prishtina - Trepça '89

Të dielën takohen:
13:00 Ferizaj - Dukagjini

LIGA E PARË - Java e 15

Të shtunën takohen:
Vitia - Ramiz Sadiku
Istogu - Trepça

Të dielën takohen:
Vllaznia - 2 Korriku
Arbëria - Onix
KEK-u - Besa
Malisheva - Liria
Vëllaznimi - Ulpiana
Dardana - Drenasi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Skuadra e Dritës është përgatitur që të arrijë fitore në ndeshjen derbi kundër Llapit, e cila zhvillohet sot (e shtunë) në Gjilan. Drita me tri pikë të reja do ta barazonte Gjilanin që pozicionohet në vendin e dytë. Mbrojtësi Fidan Gërbeshi ka thënë për gazetë se Drita synon fitore në secilën ndeshje. "Synimet tona nuk ndryshojnë në asnjë ndeshje, përfshirë edhe ndaj skuadrës së Llapit. Presim fitore në mënyrë që ta vazhdojmë garën për pozitën e parë në tabelë. Kundërshtari është mjaft i fortë dhe ka individë cilësorë, por jemi të bindur në sukses. Mungesa e vetme është e Xhevdet Shabanit, por kemi lojtarë të mirë dhe besojmë se nuk do të vërehet

mungesa e tij", ka thënë Gërbeshi.

Gazeta e ka kontaktuar edhe trajnerin e Llapit, Tahir Batatina, i cili ka shprehur optimizëm se skuadra e tij do ta nxjerrë më të mirën nga ndeshja në Gjilan. "Përballë e kemi një skuadër të mirë, Dritën, por Llapi pretendon të marrë rezultat pozitiv në këtë ndeshje. Kemi humbur nga Prishtina në ndeshjen e fundit, por kohën e gjatë që kemi pasur në dispozicion e kemi shfrytëzuar për t'i eliminuar disa gabime dhe në Gjilan shkojmë për fitore", ka thënë Batatina, i cili ka konfirmuar dy mungesa shumë të rëndësishme për këtë ndeshje. "Në këtë ndeshje kemi mungesën e Mentor Zhdrellës dhe Behar Maliqit, të cilat janë mungesa të mëdha për klubin tonë, por besojmë se do të dalim me rezultat pozitiv nga kjo

ndeshje derbi", ka deklaruar Batatina. Drita është aktualisht në pozitën e tretë me 28 pikë, kurse Llapi pozicionohet në vendin e pestë me 24 pikë të grumbulluara.

Korenica: Trepça '89, e vështirë, por besojmë në fitore

Meriton Korenica ka shprehur optimizëm se skuadra e Prishtinës do ta mposhtë Trepçën '89 në ndeshjen që zhvillohet sot në stadiumin "Fadil Vokrri". "Pas pushimit që kishim, besoj jemi përgatitur maksimalisht për ndeshjen e radhës kundër një kundërshtareje të fortë dhe të papërshtatshme siç është Trepça '89 e cila di të nxjerrë shumë probleme. Megjithatë, duke e parë formën tonë të mirë, atmosferën e shkëlqyer në

skuadër, por edhe angazhimin siç e patëm në ndeshjen me Llapin, besojmë se do të arrijmë t'i marrim pikët e plota, që do të na ndihmonin shumë në ecurinë pozitive deri në fund të stinorit", ka thënë Korenica.

Ballkani e zbret Gjilanin nga fronti

Ballkani e ka fituar derbin e javës së 16 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ndaj Ballkanit (2-1). Në këtë mënyrë skuadra e Ismet Munishit e zbret Gjilanin në pozitën e dytë dhe e rimerr pozitën e parë në elitë. Skuadra nga Suhareka e nisi mirë ndeshjen dhe kaloi në epërsi pas katërmbëdhjetë minutave lojë, kur futbollisti në topformë, Blend Baftiu, realizoi për 1-0. Golin e dytë vendësit e shënuan pas nëntë minutave lojë, por këtë

herë shënues ishte Jetmir Topalli. Gjilani e ngushtoi epërsinë në 2-1, me golin e Gerhard Prognit në minutën e 37. Pesë minuta para fundit gjyqtari kryesor e përfshoi nga ndeshja me karton të kuq Ismet Munishin, me arsyen e reagimeve të tepërta ndaj vendimeve të gjyqtarit. Pas kësaj ndeshje Ballkani është në pozitën e parë me 34 pikë, kurse Gjilani bie në pozitën e dytë me 31 pikë.

Të dielën derbi Prishtina - Peja

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Xhiroja e 12-të e Superligës së Kosovës në basketboll do të sjellë derbin e rivaleve të vjetra Sigal Prishtina - Peja. Kjo ndeshje do të zhvillohet të dielën në kryeqytet nga ora 17:00 dhe pritet të jetë shumë interesante. Prishtinasit ndodhen në vendin e tretë me 15 pikë, kurse pejanët në pozitën e pestë me 13 sosh. Ballafaqimet ndërmjet këtyre skuadrave gjithmonë kanë qenë interesante dhe kështu pritet të jetë edhe të dielën. Ndeshja hapëse e xhiros është ndërmjet Lipjanit, që ndodhet në vendin e fundit dhe Rahovecit



15 pikë. Takimi i fundit i kësaj xhiroje është në mes të Feronikelit dhe Ponte Prizrenit. Skuadra nga Drenasi ka grumbulluar 13 pikë deri më tani, kurse prizrenasit kanë dy pikë më shumë, andaj sfida pritet të jetë shumë interesante.

që është lider me 19 pikë, kurse lipjanasit kanë dhjetë pikë dhe ende nuk kanë shënuar fitore në elitë këtë edicion. Ndeshja tjetër e së shtunës është ndërmjet Trepçës dhe Golden Eagle Yllit. Mitrovicasit janë në vendin e tetë me 11 pikë, kurse therandasit ndodhen në vendin e katërt me

SUPERLIGA - JAVA 12

Të shtunën takohen:
17:00 Lipjani - Rahoveci
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Peja
19:00 Feronikeli - Ponte Prizreni

32 dy vjet pa yjet Fevzi Rama e Faton Domi

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Janë mbushur 32 vjet nga fatkeqësia në komunikacion, me ç'rast kishin ndërruar jetë dy yjet e KF Prishtina, Fevzi Rama dhe Faton Domi. Tandemi Rama-Domi, shokë të pandarë, për KF Prishtina ishin inkuadruar në filltet e para, pastaj gjeneratës së madhe të '83-shit. Së bashku me shumë futbollistë të rinj të grumbulluar nga anekënd Kosova, në fundvitet '70, derisa Prishtina kishte rënë në pikën më të ulët, atë të ish-Ligës së Parë Krahinore, në anën tjetër po krijohej dhe po grumbullohej gjenerata me shumicë futbol-



listësh shqiptarë të talentuar e që pas disa vitesh do ta bënin gjëmën në ish-shtetin jugosllav. Pa Fevzi Ramën e Faton Domin ajo jehonë nuk do të dëgjohej. Publiku prishtinas i adhuronte në fushë dhe vazhdon mos t'i harrojë asnjëherë. Rama - Domi do të mbesin sinonim i futbollit prishtinas, lavdi e kohës së shkuar të artë.


Mavraj: Në Serbi jemi larguar me helikopter nga stadiumi

TIRANË, 22 NËNTOR - Mërgim Mavraj në ndeshjet e fundjavës do ta luajë ndeshjen derbi të qytetit. Ekipi i tij Greuther Furth pret skuadrën e Nurnbergut në javën e 14-t të Bundesligës 2 gjermane. Në një intervistë për mediat

vendëse Mavraj është pyetur nëse i frikësohet derbit të së shtunës. Duke buzëqeshur Mavraj i ka treguar gazetarit ngjarjen e mbrëmjes së 14 tetorit 2014, duke zbuluar edhe fakte që deri sot nuk diheshin. "Nuk më tremb një derbi i

vogël si ai ndaj Nurnbergut. Kam luajtur në një derbi të madh. Shqipëri - Serbi ishte më shumë se një derbi, apo një luftë mund të themi. Na kanë larguar me helikopter atë natë nga stadiumi", ka thënë Mavraj. Ndeshja e 14 tetorit pa

dyshim ishte ndër më të vështirat jo vetëm për mbrojtësin shqiptar, por për të gjithë kombëtaren dhe tifozët kuqezi. Dhuna ndaj futbollistëve dhe racizmi ndaj simboleve kombëtare ishin një nga aspektet negative të mbrëmjes.



Fitojnë Milwaukee dhe New Orleansi

MILWAUKEE, 22 NËNTOR - Në NBA u zhvilluan vetëm dy ndeshje. Milwaukee Bucks në Konferencën e Lindjes priti skuadrën e Portland Trail Blazersit, e cila është në krizë të thellë në këtë fillim sezoni. Nuk pati asnjë surprizë pasi vendësit fituan me rezultatin 137-129 në

një përballje ku iu kushtua pak rëndësi fazës mbrojtëse. Shënuesi më i mirë për ekipin nga Wisconsin rezultoi Eric Bledsoe me 30 pikë. Giannis Antetokounmpo nuk mund të qëndronte pas, duke lënë shenjë me një "triple-double": 24 pikë, 15 asistime dhe 19

"rebounde". Nga ana tjetër, për skuadrën nga Oregoni spikati me 37 pikë dhe 10 asistime CJ McCollum, ndërsa Skal Labissiere shtoi edhe 22 pikë të tjera. Vjen fitorja e tretë radhazi dhe e katërta në pesë takimet e fundit për New Orleans Pelicans. Skuadra nga Louisiana

arriti të triumfojë 121-124 në një fushë shumë të vështirë si ajo e Phoenix Sunsit. Vendimtarë Brandon Ingram me 28 pikë, JJ Redick me 26 dhe Jrue Holiday që për pak realizon "double double" (23 pikë e 9 asistime). Për Suns nuk mjaftuan 25 pikët e Kelly Oubre Jr.



FIBA 'zbarkon' në Kosovë

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Me rastin e organizimit të "Final 8" të Kupës së Kosovës, Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), në bashkëpunim me FIBA Referee Department, do të organizojnë PNRC (Kampi Potencial i Gjyqtarëve Nacionalë) me thirrje të FIBA-s, të licencuar së fundi në vitin 2019. Kjo është hera e pestë që FIBA Referee Department së bashku me FBK-në organizojnë PNRC. E gjithë kjo vjen si rezultat i bashkëpunimit shumë të mirë ndërmjet FBK-së dhe FIBA-s si dhe kushteve të mira të cilat i ofron Federata e Basketbollit e Kosovës. Në këtë kamp që mbahet nga 10 deri më 14 shkurt, pjesëmarrës do të jenë nëntë gjyqtarë nga Evropa, si dhe dy instruktorë të FIBA-s, kurse do të udhëhiqet nga menaxheri i FIBA Referee Department, Davorin Nakij. Gjyqtarët e nominuar në këtë kamp do të kenë mundësinë që, përveç punës teorike, t'i gjykojnë edhe ndeshjet zyrtare të "Final 8" Kupës së Kosovës, çerekfinalet dhe gjysmëfinalet. FIBA Instruktori Nacional i Gjyqtarëve të FBK-së, Faton Kurshumlja, është shprehur shumë i kënaqur me miratimin e



organizimit të këtij kampi në Kosovë. "Ky kamp është shumë i rëndësishëm për gjyqtarët vendorë sepse i njëjti mund të monitorohet edhe nga gjyqtarët perspektivë dhe është motivim shtesë për gjyqtarët e Kosovës. Organizimi i këtij kampi dëshmon për punën që është bërë në vitet e kaluara dhe shpresojmë se do të shkojë sipas planit të paraparë. Ky kamp është një mundësi shumë e mirë për gjyqtarë vendorë që të fitojnë përvojë dhe të shkëmbejnë njohuri edhe me gjyqtarët e huaj", ka deklaruar Kurshumlja për faqen zyrtare të

FBK-së. Në këtë kamp FBK-ja do t'i paraqesë edhe gjyqtarët e saj, që do të kenë mundësi, së bashku me gjyqtarët e tjerë, të fitojnë përvojë dhe avancim sa më të mirë në gjykim. Kampi i fundit i mbajtur ka qenë pikërisht në shkurt të këtij viti në Rahovec, ku ishin mbajtur garat e Kupës së Kosovës dhe ishte vlerësuar shumë i suksesshëm, derisa nga ky kamp ishin licencuar katër gjyqtarë pjesëmarrës. Federata e Basketbollit e Kosovës do t'i bëjë të gjitha përgatitjet që edhe ky kamp të organizohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kosova e pafat, Gjeorgjia ose Bjellorusia mikpritëse të finales

NYON, 22 NËNTOR - Në selinë e UEFA-s në Nyon është hedhur shorti ku janë mësuar vendet pritëse të finaleve të "play-off"-it në kuadër të Ligës së Kombeve, ku vendosen katër kombëtalet e fundit pjesëmarrëse në "Euro 2020". Përfaqësuesja e Kosovës, e cila doli fituese e Grupit A në Divizionin D të Ligës së Kombeve, në gjysmëfinale të "play-off"-it do të luajë si mysafire e Maqedonisë së Veriut. Në rast të kualifikimit në finale, atëherë "dardanët" do të luajnë sërish si mysafirë me fituesin e çiftit tjetër të gjysmëfinales, Gjeorgji - Bjellorusi, pasi goglat e shortit nuk ishin me fat për Kosovën. Ndeshjet gjysmëfinale do të zhvillohen më 26 mars, derisa finalja më 31 mars. Në tërheqjen e shortit ishte i pranishëm edhe delegacioni i FFK-së, presidenti Agim Ademi, sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu, përzgjedhësi Bernard Challandes, ndihmësi i tij, Muharrem Sahiti dhe



menaxheri Bajram Shala. Në rast kualifikimi në "Euro 2020" Kosova do të jetë pjesë e grupit me Holandën, Ukrainën dhe Rumaninë. "Ne pothuajse e kemi ditur se cilat ekipe mund të bien në grup në rast të kualifikimit. Ajo që kemi pritur në këtë short ka qenë se a do të jemi vendës në finale ne, Maqedonia apo Gjeorgjia ose Bjellorusia. Fat i deshi që të jetë në anën e tyre, kështu që të dyja ndeshjet do t'i luajmë si mysafirë. Megjithatë, nuk kemi pse t'i frikësohemi këtij fakti, edhe pse dëshira

jonë ishte që ndeshja finale të zhvillohej në Prishtinë dhe të festonim në stadiumin dhe shtetin tonë. Sidoqoftë, ne vazhdojmë ta ndjekim ëndrën tonë dhe kam besim në kualitetin e lojtarëve dhe në punën e shtabit teknik. Ekipi ynë kombëtar ka dëshmuar se ka pozitivet dhe mentalitet fituesi, andaj sigurisht se do të punojmë dhe do të besojmë në suksesin tonë në të dyja këto ndeshje, në mënyrë që ta arrijmë kualifikimin e parë dhe historik në "Euro 2020", ka thënë Ademi, kryetar i FFK-së.

SHKURT

Hamiltoni: Nuk tërhiqem pa fituar titullin e shtatë

"Nuk kam ndërmend të tërhiqem. Po shijoj momentin, por jam në kërkim të stimuljeve të tjerë për të ardhmen", u shpreh Lewis Hamiltoni pas zërave se mund të tërhiqet në fund të vitit 2020, pasi ta përfundojë kontratën që ka me makinën Mercedes. "Dua që sezonin tjetër ta fitoj titullin e shtatë kampion. E urrej veten kur humbas një garë edhe pse jo kaq shumë sa kur isha i ri që nevrokosesha shumë", u shpreh britaniku, me gjashtë tituj kampionë bote në Formula 1. Gjithsesi, Hamiltoni e di mirë se sezonin e ardhshëm do të hasë në një rivalitet më të madh. "Leclerc dhe Verstappen do të jenë kampionët e ardhshëm të botës, por shpresoj jo vitin tjetër. Janë të rinj dhe pilotojnë mjaft mirë, por përvoja ime mund ta bëjë dallimin për t'ia dalë sërish mbanë", ka deklaruar Hamiltoni.

Mourinho e kërkon Ibrahimoviçin në Tottenham

Trajneri Jose Mourinho dhe sulmuesi Zlatan Ibrahimoviç mund të bashkohen sërish, pasi trajneri portugez e ka marrë drejtimin e Tottenham Hotspurit. Mourinho dhe Ibrahimoviç kanë punuar edhe në të kaluarën së bashku, prandaj strategu portugez e dëshiron në Tottenham si zëvendësues Harry Kane. Në garë për Ibrahimoviçin është edhe skuadra e Milanit, ku edhe vetë lojtari e ka pohuar mundësinë për një rikthim të mundshëm në "San Siro".

Sarri konfirmon mungesën e Ronaldos

Cristiano Ronaldo pritet të mungojë në ndeshjen e ardhshme të Juventusit. Trajneri Sarri në konferencën për shtyp konfirmoi një gjë të tillë. Portugezi u kthye me probleme fizike nga impenjimi me kombëtaren, për këtë arsye po ndjek një program individual stërvitor, për ta lënë pas shqetësimin muskullor të javëve të fundit. Objektivi i stafit të bardhezinjve është të jetë i gatshëm për ndeshjen e Championsit kundër Atletico Madridit. "Mes meje dhe tij nuk është i nevojshëm asnjë sqarim pas zëvendësimit kundër Milanit. Janë gjëra normale që ndodhin gjithmonë. Në Bergamo, me 99 për qind të mundësive nuk do të jetë", ka thënë Sarri. E sigurisht, në vijim të përgjigjes për marrëdhënien e tij me Ronaldon, Sarri sqaroi: "Edhe kur luajnë diletantët ka gjëra të tilla në çastet e ndërimeve. Unë vij nga vitet '90 dhe ose do ta kaloja kohën duke sqaruar ose do të mësohesha me raste të tilla dhe do t'i lija futbollistët të shfrynin".

Zidane: Bale mund të jetë sërish vendimtar për Realin

Gareth Bale ishte pika kryesore në konferencën për shtyp të premten për Zinedine Zidane. Futbollisti bëri një festim kontrovers me një flamur që renditi përparësitë e tij si Uells, Golfi dhe më pas Real Madridi. "Kur u kthye, i fola ashtu si të gjithë lojtarëve. Ne folëm për çështje në fushë, jo për çështjet jashtë fushës. Ai ndihet mirë dhe ka stërvitur normalisht. Mendoj se është bërë shumë zhurmë rreth gjetit të Bales, por ajo që duhet të bëjmë është përqendrimi në futboll. Unë po shikoj vetëm anën sportive të gjërave, jo ato që thuhet jashtë klubit. Ajo që thuhet jashtë nuk më intereson", ka thënë Zidane. "Kur shikoni se çfarë ka bërë ai gjatë kohës së tij këtu, tifozët duhet të jenë me të. Njerëzit që me të vërtetë ndiejnë ngjyrat e Real Madridit duhet të jenë me Balen. Mendoj se ai mund të jetë përsëri një lojtar vendimtar dhe mendoj vetëm për këtë. Unë jam duke llogaritur te Bale. Kjo nuk është asgjë e re", ka shtuar Zidane.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në
Shitjen 52

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: e **hëne 25 nëntor 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,
në **“Sallën e konferencave - Hotel Grand”**, Prishtinë.

*** Shënim: Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja e aseteve 52:**


Njësia nr. 105-NSH NBI Rahoveci – Prona në Xërxe 7

Njësia nr. 122-NSH Zadruga Shtërpce – Tokë bujqësore në Biti të Epërme 6

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një pliko (zarf) të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
Brenda këtij zarfi (**ZARFI 3**), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: **ZARFI 1** dhe **ZARFI 2**



* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 52 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**
Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevi Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë

tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2005, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076 e-mail: sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të bazës të nenit 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, për Marrëdhënjet e Detyrimeve, Sekretariatit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bënë:

**Shpallje të konkursit publik
Për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

1. Emri i Institucionit:	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
2. Titulli i Vendit të Punës:	Zyrtar i Lartë për Financa / Zotues
3. Numri i referencës:	KQZ-22/2019
5. Grada e Vendit të Punës:	NP – G7 / K – 12.8
6. Lloji i kontratës :	Me kohë të caktuar
9. Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Financave
10. Vëndndodhja:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Siguron dhe mban evidencën e zotimeve sipas planit buxhetor.
2. Përgatit dhe kompletin lëndët për pagesë me dokumentacionet valide përcjellëse dhe të nënshkuara nga zyrtarët përkatës.
3. Është përgjegjës për regjistrimin e zotimit në SIMFK.
4. Në bashkëpunim me Menaxherin e Personelit, bën llogaritjen e pagave dhe kompensimeve në përputhje me buxhetin.
5. Përgatit raportin mujor, tremujor dhe vjetor në lidhje me mjetet e zotua dhe të realizuara.
6. Pranon faturat dhe verifikon nëse janë paguar dhe i proceson për pagesë.
7. Kryen dhe detyra tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi.
- 8.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

Diplomë Universitare në Ekonomi, Financa dhe të ngjashme;
Trec (3) vite përvojë pune profesionale;
Integritet të lartë personal dhe profesional;
Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
Njohja e gjuhës tjetër zyrtare c dëshirueshme;
Njohje e gjuhës angleze me gojë dhe me shkrim e dëshirueshme;
Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

Procedura e konkurimit

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e personelit apo në webfaqen e KQZ-së, në linkun www.kqz-ks.org.
Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs, në zyrën e personelit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rruga "Migjeni, nr. 21. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës dhe trajnimet e ndjekura.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur tetë (8) ditë nga dita e publikimit, nga data 23.11.2019 deri me 02.12.2019.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » FC Network « SH.P.K., me seli në PRIZREN, TREPÇA NR:13, ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810184531 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

OBAVEŠTENJE

Obavještavamo sve kliente da društvo » FC Network « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, TREPÇA NR:13, doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810184531 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije. Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u rokuod 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the company » FC Network « L.L.C., based in PRIZREN, TREPÇA NR:13, has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810184531 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » Sierra Company « SH.P.K., me seli në PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810155144 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

OBAVEŠTENJE

Obavještavamo sve kliente da društvo » Sierra Company « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N, doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810155144 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u rokuod 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that the company » Sierra Company « L.L.C., based in PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N, has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810155144 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu Zakona br. 04 / L-077 o obavezanim odnosima, Sekretarijat Centralne izborne komisije objavljuje:

**Objavlivanje javnog konkursa
o Sporazumu za posebne usluge**

1. Naziv institucije:	Centralna izborna komisija
2. Naziv radnog mesta:	Viši službenik za finansije/Zotues
3. Referentni broj:	CIK-22/2019
5. Stepën radnog mesta:	NA – G7 / K – 12.8
6. Vrsta ugovora :	Na određeno
9. Izveštava kod:	Rukovodiocu Divizije
10. Lokacija:	Prishtina

Zadaci i odgovornosti:

1. Obezbeduje i održava evidenciju odvajanja u skladu sa planom budžeta.
2. Priprema i kompletira za isplatu predmete sa važećom pratećom dokumentacijom koji su potpisani od strane nadležnog službenika
3. Odgovoran je za evidentiranje obaveza u ISUFK
4. U saradnji sa Kadrovskim rukovodiocem vrši obračun plata i naknada u skladu sa budžetom,
5. Pripremiti mesečni, kvartalni i godišnji izveštaj u vezi sa odvojenim i realizovanim finansijskim sredstvima ,
6. Prima fakture, proverava da li su plaćene i procesira ih za isplatu
7. Obavlja i druge dužnosti koje mu odredi direktni nadzornik.

Kvalifikacije, veštine i radno iskustvo:

Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, finansija i slično;
Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva,
Visok lični i profesionalni integritet;
Odlične veštine usmene i pisane komunikacije na službenim jezicima;
Sposobnost i spremnost da rade nepristrasno i sa ljudima različite etničke pripadnosti;
Poželjno je poznavanje drugog službenog jezika;
Poželjno usmeno i pismeno je poznavanje engleskog jezika;
Poznavanje informativne tehnologije (MS Word, MS Excel i MS Access).

Postupak nadmetanja

Obrasci za zapošljavanje mogu se preuzeti u kadrovskoj kancelariji ili na web stranici CIK-a na linku www.kqz-ks.org. Obrasci za zapošljavanje podnose se umutar roka određenog konkursom, u Kadrovskoj kancelariji u SCTK-u, ulica "Migjeni" br. 21. 10000 Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00.

Obrascu za zapošljavanje prilažu se i kopije neophodnih ličnih dokumenata i dokazi o kvalifikaciji, radnom iskustvu.

Centralna izborna komisija pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i podstiče prijave svih osoba muškog i ženskog pola, kao i članova svih zajednica na Kosovu, uključujući i osobe sa ograničenim sposobnostima.

Prijave dostavljene nakon predviđenog roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Samo kandidati izabrani u užu krug će biti kontaktirani.

Rok za prijave je otvoren osam (8) dana od dana objavljivanja, od 23.11. 2019. do 02.12. 2019.

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.P. "PRO TEX" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70811111 dhe të nr. fiskal 600753596.

► "HELLO G" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810024852.

► Rahime Krasniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Hoxhë Kadri Prishtina" drejtimi Ekonomik Kontabilitet në Prishtinë.

► Armend Xhoni shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit në Universitetin AAB - drejtimi Muzikologji në Prishtinë.

► Luan Susuri shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Adile Ibollari shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Qenan Shishko shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Edis Selimko shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Zylfi Shigjeqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Vëllezërit Frasheri" Pllanej.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

